



love you without knowing
Sislej Xhafa

curated by / kuruar nga:
Jérôme Sans

love you without knowing

Sislej Xhafa

love you without knowing / Sislej Xhafa

Kuruar nga / Curated by:
Jérôme Sans

Kohëzgjatja e ekspozitës / Exhibition dates:
05.07.2018-25.08.2018

Katalogu-Catalogue

Botues / Publisher:
Galeria Kombëtare e Kosovës / National Gallery of Kosovo

Teksti / Text:
Jérôme Sans, Eli Krasniqi, Veton Surroi, Blearta Jashari, Dardan Islami

Fotografitë / Images:
Enver Bylykbashi

Përkthimi dhe lektura / Translation and proofreading:
Artan Muhaxhiri

Përkthimi i poezisë / Poem translation:
Fadil Bajraj

Dizajni / Design:
TREMBELAT

Shtypi / Print
VIPRINT

Viti / Year: 2018

Ekspozita dhe katalogu janë realizuar me mbështetje nga / The Exhibition And Catalogue Are Supported by Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve / the Ministry of Culture, Youth and Sports/ Ambasada Amerikane / US Embassy / Kuvendi i Republikës së Kosovës / Republic of Kosovo Assembly / Komuna e Prishtinës / Pristina Municipality / Komuna e Pejës / Peja Municipality / Bavaria / Galleria Continua / Blain|Southern Gallery



GALLERIACONTINUA
SAN GIMIGNANO - BELJING - LES MOULINS - HABANA

BLAIN|SOUTHERN

B.BAVARIA

Sponzorë Medial / Media Sponsors:



Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës- National Gallery of Kosovo staff:
Arta Agani, Drejtoreshë -Director; Zeni Ballazhi, Kurator-Curator; Mexhide Maxhuni, Zyrtare për financa -Finance officer; Lirije Buliqi, Zyrtare e lartë administrative -Senior administrative officer; Naim Spahiu, Koordinator për ekspozita -Coordinator for exhibitions; Enver Bylykbashi, Fotograf profesional -Professional photographer; Skender Xhukolli, Teknik për ekspozita -Exhibition technician; Rrahman Bislmi, Teknik për ekspozita/Mirëmbajtës i objektit -Exhibition technician /Building caretaker; Xhevat Rrahimi, Kujdestar i sallës ekspozuese -Exhibition hall attendant; Valdet Sylja & Mentor Abdullahu, roje nate -security guards

Falenderime të veçanta për / Special thanks to:

Kuvendi i Kosovës / Kosovo Assembly, Kadri Veseli, Valdete Idrizi, Komuna e Prishtinës/ Municipality of Prishtina, Shpend Ahmeti, Yll Rugova, Ambasada Amerikane në Prishtinë / U.S. Embassy in Prishtina, Ambasador Greg Delaëie, Richard May, Erin Mains, Enis Rexhepi, Isuf Cikaqi, Ministria e Bujqësisë /Ministry of Agriculture, Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve/ Kosovo Institute for Monument Protection, Komuna e Pejës / Municipality of Peja, Gazmend Muhaxhiri, Durim Sheremeti, Ansambli i Qytetit të Gjakovës/ City Ansamble of Gjakova, Pëllumb Vula, Endrit Xërxa, Adea Pula, Eni Pirana, Agron Blakçori, Ari Zharku, Laureta Hajrullahu, Shkamb Jaka, Dardan Sopa, Basri Avdiu, Arben Avdiu, Galeria Continua, Lorenzo Fiaschi, Kuralai Abdukhalikova, Galeria Blain Southern, Marie Siguier, Christiana Colli, Dardan Islami, Kino Armata, Alush Gashi.

Përmbajtja / Table of Content

Ëndrra e huaj / Strange Dream - Dardan Islami	10
Sislej Xhafa / Love You Without Knowing - Jérôme Sans	12
Kujtesa fillon menjëherë / Memory Begins Immediately - Veton Surroi	20
Arti emancipues i Sislej Xhafës – Ftesë me guxu /	
Emancipatory Art of Sislej Xhafa – An Invitation to Dare - Eli Krasniqi	36
Rebel me arsye / Rebel With a Cause - Blearta Jashari	44
Një pasdite me vapë të madhe / A dog day afternoon -	
Sislej Xhafa, intervistuar nga Jérôme Sans /	
interviewed by Jérôme Sans	130
Sislej Xhafa - CV	140





Ëndrra e huaj

— Dardan Islami

Askush nuk ka të drejtë të ma ndalojë
dëshirën për orgazëm
fantazinë, lirinë, barazinë,
u përpoqën por dështuan,
më detyruan të emigroja larg.

Vij nga një sistem i dështuar, u thash,
kompleksin po e mbaja brenda vetes,
pa e shfaqur, pa e kuptuar,
ndjehesha i paftuar,
vetëm atë ëndërr kisha.

Malli për atdhe më bënte agresiv
krenaria po më zmadhohej tej mase nga
pasiguria,
ndjehesha i zbrazët,
kjo na është ëndrra ime, thash.

Ëndrra ime ka plot ngjyra,
po e ushqeja me shpresë, me dashuri,
kisha frikë se po më vdiste.

Po flija, po zgjohesha me ëndrrën
se një ditë do krenohem me ju.

Strange Dream

— Dardan Islami

No one has the right to forbid my
desire for orgasm
fantasy, freedom, equality,
they tried but failed,
they forced me to emigrate far away.

I come from a failed system, I told them,
and I kept the complex within myself,
without showing, without understanding,
I felt uninvited,
all I had was that dream.

The longing for my homeland was making
me aggressive
my pride was greatly enlarging from
uncertainty,
I felt empty,
this is my dream, I said.

My dream is full of colors,
I was feeding it with hope, with love,
I was afraid it was dying.

I used to sleep and wake up with the
dream,
that one day I would be proud of you.

përkthyer nga / translated by:
Fadil Bajraj

Sislej Xhafa /

love you without knowing

— Jérôme Sans

Kurator:
Jérôme Sans

Galeria
Kombëtare e Artit,
Prishtinë, Kosovë

Ekspozita e parë e Sislej Xhafës në Kosovë, *love you without knowing*, është shprehje e dashurisë së artistit ndaj atdheut – brishtësisë, fuqisë, gjallërisë dhe dhunës së tij. Ekspozita përbëhet prej rreth 15 veprave, të harkut kohor nga të 1990-at deri në të tashmen, që janë mjaftueshëm fleksibile për t'iu përshtatur mundësive të rikrijimit, ashtu siç do të duhej të interpretohej një ndarje. Procesi i rigjallërimit të veprave është mundësi që artisti ta rikonsiderojë vendin e tij jo prej s'jashtmi, me anë të importimit të objekteve dhe veprave tashmë të krijuara dhe të përfunduara, por në të kundërtën - ta rimendojë përvojën artistike prej s'brendshmi, nga niveli lokal, që së bashku me personalitete kosovare të krijojnë vepra të atypëratyshme të cilat e përbëjnë ekspozitën. Përunjësisht, qëllimi i ekspozitës është që t'i marrë në konsideratë të gjithë artistët dhe individët e mbetur në Kosovë, me qëllim që t'iu ofrojë atyre mundësinë ta jetojnë me intensitet të njëjtë përvojën e veprave të artit esencialisht të përfshira me të tashmen e jetuar dhe kohën e trupëzuar të ekspozitës, që nis këtu, në Kosovë.

I lindur në vitin 1970, në Pejë, Xhafa ka jetuar ekzistencë nomade që nga largimi prej Kosovës në vitet e para të të 1990-ave, e cila e dërgoi në Londër, Itali, e pastaj në Nju Jork, ku jeton dhe punon. Gjendja e udhëtarit të palodhshëm ia lejon Sislej Xhafës të jetë vazhdimisht në kontakt me transformimet sociale, ekonomike dhe estetike të botës sonë globale. Me praktikën konceptuale të ngarkuar politikisht dhe shoqërisht, e cila përdor medime të ndryshme nga piktura dhe vizatimi deri tek skulptura dhe instalacioni, Xhafa i sfidon stereotipat kulturorë, normat sociale dhe strukturat institucionale. Instalacionet e tij përdorin materiale të dobëta, por janë të pasura me domethënie. Në procesin e aktit kreativ, fragmentet e realitetit rrezatojnë kode komplekse të nostalgjisë dhe revoltës, të ngulitura me një emocion të thellë të artistit i cili absorbon çdo fenomen me ndjeshmëri të pazakonshme. Thjeshtësia dhe menjëherëshmëria në dukje e veprave të tij,

çdoherë fshehin shumësi të leximeve të mundshme.

Kërkimi i tij mospërfillës hulumton funksionet e shoqërisë bashkëkohore, realitetet sociale, ekonomike dhe politike, me qëllimin përfundimtar që t'i bëjë kritikë konsumerizmit dhe mekanizmave të tij. Ilegaliteti i detyruar, dekonstruktimi i mitologjive, ose mohimi i të drejtës për të votuar, janë në themelin e angazhimit të tij politik i cili gjithmonë është indirekt dhe i nënkuptueshëm. Veprat e tij synojnë t'i sfidojnë shikuesit që t'i njohin simptomat dhe çarjet e shoqërisë globale bashkëkohore.

Thellësisht të ndërlihdura me nocionin e kufijve, projektet e Xhafës përfshihen në debatin politik mbi emigracionin, duke u lëkundur mes lidhjes intime me kulturën e historinë kosovare dhe prirjes së fuqishme për ta zbuluar tjetrin.

Në vitin 1997, duke e vënë në pikëpyetje stereotipin e vet - atë të emigrantit – ai hyri ilegalisht në Bienalen e Veneçias, dhe e shpalli veten akter të *Pavijonit Klandestin Shqiptar*. Në *Piazza della Signoria* (1999), Xhafa u shndërrua në kriminel, aktroi si hajdut xhepush në sheshin e mbushur me njerëz, duke e ndjekur pas një person nga Maroku me qëllim që t'i mposhte stereotipat racistë. Hulumtimet e tij mbi fenomenin e turizmit ose të ilegalitetit të detyruar përdorin gjuhë ironike dhe subversive, sikurse në performansën *Stock Exchange* (2000), në të cilën ai e merr rolin e një komisionari që nuk shet aksione, por blen dhe shet nisjet dhe arritjet e trenave.

Barka (2011), anija e bërë prej qindra këpucëve shtrou pyetje për eksodin e migrimit dhe situatave të konfliktit që e karakterizojnë bashkëkohësinë. *Rocket Ship* (2011) – një karrocë dore e ndryshkur, e mbushur me drita vezulluese elektrike të Vitit të Ri – i referohet kujtesës fëmijërore: premtimit të xhaxhait të tij që t'i sjell dhurata gjatë një vizite në Pejë. Edhe pse titulli premtim udhëtim fantastik, vet objekti është pafuqishmërisht i izoluar, një aluzion për migrimin si temë të përsëritur të Xhafës.

Në vitin 2017, Xhafa përfaqësoi Republikën e Kosovës në Bienalen e Venecias me instalacionin *Lost and Found*, i cili synon ta theksojë dinjitetin njerëzor, drejtësinë dhe transparencën përkundër proceseve të padrejtësisë.

Në *Woven Soil* (2018), vepër e krijuar enkas për këtë ekspozitë, Xhafa e transformon hapësirën e ekspozitës duke e mundësuar depërtimin përmes një dritareje të hapur nga jashtë, njëjtë si në një pikturë rurale, të stallës reale të lopëve, në fqinjësi me muzeun.

Hap pas hapi, veprat e Xhafës me subtilitet dhe konsistencë tërheqin vëmendjen për sistemet e padukshme dhe shpesh të padrejta të cilat i strukturojnë jetët tona dhe na inkurajojnë të reflektojmë në aspektin personal dhe kolektiv mbi fenomenet sociale, ekonomike dhe politike të botës sonë. Devijimi në raport me të papriturën mund t'i vë në pikëpyetje vlerat tashmë të përfituara dhe t'i destabilizojë siguritë e zhvilluara për ta shfaqur tek secili prej nesh një formë të vetëdijes dhe forma të reja të të hapurit.

Sislej Xhafa /

love you without knowing

— Jérôme Sans

Sislej Xhafa's first exhibition in Kosovo, *love you without knowing*, is a declaration of love from the artist to his homeland, to its fragility, strength, vitality and violence. The exhibition comprises about fifteen works, spanning his itinerary from the 1990s through the present, which are flexible enough to lend themselves to the possibilities of a reenactment, such as a partition that would have to be reinterpreted. The process of revivification of the works is a way for the artist to reconsider his native country not from the outside by importing objects and works already produced and completed, but on the contrary to rethink the artistic experience from the inside, at the local level by producing on site with local personalities the works that compose the exhibition. Humbly, the aim of the exhibition is to take into consideration all the artists and individuals left in Kosovo in order to offer them the chance to live with the same intensity the experience of artworks intrinsically engaged with the living present and embodied time of the exhibition which begins here, in Kosovo.

Born in 1970 in Peja, Xhafa has lived a nomadic existence since leaving Kosovo in the early 1990s that took him to London, Italy and then to New York where he lives and works. The condition of a tireless traveler allows Sislej Xhafa to be constantly in contact with the social, economic and aesthetic transformations of our global world. With a politically and socially charged conceptual practice that draws on multiple mediums from painting and drawing to sculpture and installation, Xhafa challenges the cultural stereotypes, social norms and institutional structures. His installations use poor materials, but they are rich in meaning. In the process of the creative act, fragments of reality emit complex codes of nostalgia and revolt, inculcated by a profound emotion of the artist who absorbs each phenomenon with an unusual sensitivity. The apparent simplicity and immediacy of his works hides every time a plurality of readings available.

His irreverent inquiry investigates the contemporary

Curated by
Jérôme Sans

GAK,
National Gallery
of Kosovo,
Prishtina, Kosovo

society functions, the social, economic and political realities to ultimately critique consumerism and its mechanisms. The forced illegality, the deconstruction of mythologies or the denial of the right to vote are at the earth of his political engagement which is always indirect and implied. His works aim to challenge viewers to recognize the symptoms and cracks of contemporary global society.

Deeply linked with the notion of borders, Xhafa's projects engage with the political debate of immigration, oscillating between an intimate connection with Kosovar culture and history and a strong propensity to discover the other.

In 1997, questioning his own stereotype, that of an immigrant, he illegally entered in the Venice Biennale proclaiming himself as an actor of the *Albanian Clandestine Pavilion*. In *Piazza della Signoria* (1999), Xhafa became the criminal himself, acting as a pickpocket in the crowded square, walking after person from Morocco, in order to defeat racist stereotypes. His investigations into phenomena of tourism or forced illegality use an ironic and subversive language as in the performance *Stock Exchange* (2000), in which he endorses the role of a broker who does not sell shares but buys and sells the departures and arrivals of trains.

Barka (2011), a boat made of hundreds of shoes questions the migration exodus and conflict situations that characterize the contemporaneity. *Rocket Ship* (2011) – a rusty wheelbarrow filled with glowing electric fairy lights – refers to a childhood memory: his uncle's promise to bring back presents from a visit to Peja. While the title promises a fantastic journey, the object itself was helplessly isolated, an allusion to Xhafa's recurring theme of migration.

In 2017, Xhafa represented the Republic of Kosovo at the Venice Biennale in 2017 with his installation *Lost and Found* which aims to highlight human dignity, justice and transparency towards the processes of injustice.

In *Woven Soil* (2018), specially made for this exhibition,

Xhafa reverses the exhibition's space by making penetrate through a window opened on the outside, just like a rural painting, a real cowshed, adjoining the museum.

Step by step, Xhafa's works subtly and consistently drawn attention to the invisible and often unjust systems that structure our lives and encourages us to reflect, both in personal and collective terms, on the social, economic and political phenomena of our world. The deviation towards the unexpected can put into question values already acquired and destabilize our acquired certainties to bring out in each of us a form of awareness and new forms of openness.

Kujtesa fillon menjëherë

— Veton Surroi

Rreth ekspozitës
së Sislej Xhafës,
*love you without
knowing*,
Galeria
Kombëtare e
Kosovës,
Prishtinë,
6 korrik 2018

Gjiri

Dashuria është të japësh e të japësh fillon nga gjiri.

Është detyrim fillimisht ekzistencial, nevoja e nënës që të krijojë mundësinë e mbijetesës biologjike të foshnjës. Te nëna që nuk është gjitare, një shpezë fluturake, është një copë ushqimi e mbledhur në sipërfaqe toke a në sipërfaqe uji që i sillet foshnjës, i copëtohet për të mundësuar absorbimin në organizëm.

Nëna ka nevojë të japë në mënyrë që të krijojë jetë. Foshnja që merr jetë këtë e quan (kur do t'i gjejë fjalët për to) mbijetesë dhe dashuri.

Mbijetesa dhe dashuria bëhen kështu bashkë.

Kjo quhet altruizëm. Në evolucionin filogjenetik të shtazëve mbërrin te shtaza më e avancuar, njeriu. Njeriu e ka të lindur altruizmin, prej momentit kur i është drejtuar gjirit të nënës.

E ka aq të lindur sa që në kodin e vet të sjelljes dhënia, dhurata, përmbush dy nevoja elementare. Përmbush nevojën e brendshme, të lindur, për të dhënë. Dhe po ashtu përmbush nevojën e brendshme për siguri: të japësh është forma primare e krijimit të sigurisë. Majmunët që nuk duan të luftojnë me fisin tjetër të majmunëve për resurset pyjore i japin ca nga frutat e tyre fisit tjetër. Marco Polo dhe aventurierët e tjerë për në tokat e largëta gjithnjë marrin me vete dhurata për takimet me popujt e panjohur; janë shenja për nxitjen e sensit primar të altruizmit.

Nëna dhe foshnja e kanë lehtë të krijojnë lidhje altruistike. E ka të lehtë familja. E ka të lehtë kombi. E kanë të lehtë tregtarët që japin dhurata si hyrje në një relacion tregtar. E kanë të lehtë pjesëtarët e një kombi. Altruizmi i nënës është shpërblim me qumësht për foshnjën, është ushqim dhe veshmbathje për familjen, është kontratë tregtie për afaristët, është siguri për kombin. Në të gjitha ekziston shpërblimi.

Por, *loving without knowing*, të dashurosh pa ditur - pa ditur kë, çka apo pa e ditur as vet se po e bën - është altru-

izëm në kuintesencë. Diçka si një gji për të gjitha foshnjat e botës, një sqep për të gjithë zogjtë planetarë.

Lëvizja (1)

Njeriu e ka të lindur mundësinë e lëvizjes në shtigje të gjata prej momentit kur është detyruar të vrapojë pas shtazëve për ushqim. Shtazët tjera kanë kuptuar që herët se shtaza e quajtur njeri është e rrezikshme për to dhe kanë përdorur shpejtësinë e tyre dhe qëndrueshmërinë për të shpëtuar prej të shndërruarit në ushqim. Njeriu krijoi armët për të fituar përparësi, por prapë iu deshën këmbët e shpejta dhe qëndrueshmëria e shtigjeve të gjata për të zënë prenë.

Njeriu e ka të lindur edhe nevojën e të qëndruarit në një vend prej se zbuloi se barishtet e egra fisnikërohen në grurë që pastaj bëhet bukë. Prej bukës bën vendbanim, kolektivitet, kufij dhe pushtete që bëjnë rishpërndarjen e grurit dhe bukës së tepërt.

Njeriu ka kohë që është i zënë ngushtë duke kuptuar se cili prej atyre dyve është. Është ai që lëviz në shtigje të gjata, duke kërkuar me forcën e këmbëve dhe me invencionin e armëve fusha të reja gjahu, ushqimin për dimrin e gjatë dhe familjen e madhe që duhet ta mbijetojë atë? Apo është ai që mbjell dhe korr dhe duke mbjell dhe korr krijon çdoherë një tepricë për të cilën duhet vrarë mendjen se si të futet më së miri në përdorim.

Në zgripin në të cilin është njeriu, ai i këmbëve të shpejta dhe ai i nevojës të rrijë në një vend, bën një zbulim epokal, një *Rocket Ship* (2011), diçka që do të krijojë mundësinë e lëvizjes së shpejtë në vend.

Lëvizja (2)

Një prej njerëzve që hoqi dorë nga gjahu, por nuk deshi të rrisë grurë, vendosi se do të jetojë duke mbledhur tregime.

Tregimet qenë të nevojshme si shenja për gjahtarët dhe shenja për bujqit. Tregimi dhe tregimtari bënin me dije se ku e kur ishte bërë gjahu; dhe kështu shpikën kohën e kaluar dhe gjeografinë. Tregimi dhe tregimtari bënin me dije kur do të bëheshin të korrat dhe deri ku shtriheshin të mbjellat. Kështu shpikën kohën e ardhshme dhe gjeografinë.

Sille kah ta kthesh tregimin, kah e kaluara a e ardhmja, tregimtarët i ktheheshin gjeografisë.

Një ditë tregimet dhe tregimtarët u futën në anën e brendshme të ceradës së një kamioni, prodhimi *Concetto in Exile*, modeli 2016.

Lëvizja (3): *Barka* 2011

Është i veshur me rrobat e veta më të mira sepse ne, njerëzit që ikim, i veshim fëmijët tanë me rrobat më të mira. Duam që ata që na presin, kur ne ikim, të na shohim më së miri. Nuk duam që të na shohin si ikanakë. Duam që të na shohin ashtu si jemi, ndoshta edhe më të mirë se jemi. Nuk duam të koritemi. Nuk duam të koritemi edhe kur e dimë se nuk do të hamë, nuk do të pimë, nuk do të dimë ku do të flemë. Duam të dinë se kur kemi ikur kemi pasur një copë vete dhe se nuk e lamë pas. Kemi lënë shumëçka tjetër. Ndonjëherë shpresën, ndonjëherë gëzimin, ndonjëherë forcën që të na shpjerë te e mira.

Kur e veshim me rrobat më të mira duam të dinë se ne kujdesemi për tanët, edhe kështu, edhe kur ikim. Duam të dinë se kur kemi lënë ndonjëherë shpresën, ndonjëherë gëzimin, ndonjëherë forcën që do të na shpjerë te e mira, nuk e kemi lënë prapa veten. Atë që e kemi rigjetur në mëngjes, kur e kemi veshur të birin me rrobat më të mira.

Sepse ato, rrobat më të mira, do ta mbrojnë prej qiellit që errësohet, valës së detit, shpirtrave të këqij. Do ta mbrojnë prej fatit.

Do t'ia ndjellin të mirën. Atë që na humbi ne, njerëzve që ikim.

Ato, rrobat më të mira, do ta çojnë në bregun tjetër, atë breg që është krejt tjetër prej këtij në të cilin jetojmë; në bregun tjetër ku nuk të zgjojnë pushkët, as barku i zbrazët e as

ëndrra frikësuese e prindërve se e nesërmja nuk do të gdhijë.

Ne, njerëzit që ikëm, njerëzit që ikim, ne shqiptarët dhe të gjithë të tjerët si ne, humbëm një tonin sot. E kishim veshur me rrobat e veta më të bukura. Dinim se do të sfidonte qiellin e errësuar, edhe valët, edhe shpirtrat e këqij.

Kaq dinim.

Ai që do ta përkthejë këtë në gjuhë të tjera le ta bëjë. Sonte kisha ndjenjën se vdekja e fëmijës në brigjet e asaj ane, të pambrojturës, tingëllonte shqip, aq shqip sa nuk mund ta përktheja, aq shqip sa mezi e përmbylla; aq shqip sa lotët nuk më lejojnë ta shkruaj në gjuhë tjetër.

(Vdekja e Aylan Kurdit, 2 shtator 2015)

Lëvizja (4)

Njeriu i gjahut dhe ai i grurit kanë të përbashkët shenjtërimin. Ai i gjahut zbulon se ka ujë dhe gazela dhe mungesë të gjuetarëve të tjerë dhe beson se qe bekuar prej zotave për këtë dhuratë. Ngrit një totem dhe e konsideron se ajo tokë, tashmë e shpallur e shenjtë, do të mbrohet nga figura e Hyut të cilën Njeriu, i quajtur artist, e ka krijuar me kaq mjeshtri.

Njeriu i grurit beson se të korrat që po i vijnë vit pas viti mund të kenë qenë jo vetëm fryt i punës së tij, por edhe i Hyut, që dha kaq shumë shpërblime për një mund pa hile. Dhe është e qartë se do shpallur si Tokë të shenjtë, me totemin që do ta mbrojë këtë Tokë të shenjtë nga insektet, breshëri dhe njerëzit e huaj.

Tokat e shenjta janë aq të shenjta sa mbrohen me luftë dhe zaptohen me luftë. Ato që mbrohen mbetën me totemet që ishin, ato që zaptohen a çlirohen, varet se kush si e sheh, kanë toteme të reja, shenjtërohen përsëri.

Nuk dihet ku mbeten - ato trupa, koka, eshtra, copë flokësh e gjymtyrësh, këpucë dhe biberonë, xhinse dhe xhaketat e para të marra me urgjencë ikjeje - pjesëtarë gjuetarësh e bujqish, toka e shenjtë e të cilëve u shenjtërua nga të tjerët.

Shenjtëruesit e rinj kanë nevojë që të mos ketë gjë: as trupa, koka, eshtra, copë flokësh e gjymtyrësh, këpucë dhe biberonë, xhinse dhe xhaketat e para të marra me urgjencë ikjeje e as kujtesë për trupa, koka, eshtra, copë flokësh e

gjymtyrësh, këpucë dhe biberonë, xhinse dhe xhaketat e para të marra me urgjencë ikjeje.

Në fund, ekziston një totem i ri që është krijuar që të zëvendësojë ato të tokave të shenjta, Zyra për *Lost and Found* (2017). Mund të deponohen koka, eshtra, copë flokësh e gjymtyrësh, mund të kërkohen këpucë dhe biberonë, xhinse dhe xhaketat e para të marra me urgjencë.

Është edhe një telefon për të kërkuar kujtesë, por herën e fundit që u kontrollua nuk kishte sinjal, një prishje që nuk është e përkohshme sikur është jeta.

Lopët

Në *Njëqind vjet vetmi* të Gabriel Garcia Marquezit, familja Buendia heton se ka filluar t'i harrojë emrat e gjërave të zakonshme të cilat i përdor në përditshmëri. Dhe e vunë në praktikë një metodë në tërë shtëpinë, e pastaj ia imponoi tërë fshatit. Njëri prej tyre shënoi “çdo gjë me emrin e vet: tavolina, karrigia, ora, dera, muri, shtrati, tenxherja. Shkoi në ahur dhe shënoi shtazët dhe bimët (...). Pak nga pak, duke studiuar mundësitë e pafund të harresës, iu bë e qartë që mund të vinte dita që të mund të identifikoheshin gjërat për nga shënimi, por të mos mbahej mend përdorshmëria e tyre. Atëherë u bë më eksplikit. Shenja që ia vari lopës në qafë ishte mostër shembullore e mënyrës me të cilën ishin të gatshëm ta luftonin harresën banorët e Makondos: kjo është lopa, duhet mjelë çdo mëngjes që të prodhojë qumësht dhe qumështin duhet vluar për ta përzier me kafe dhe për të bërë kafe me qumësht. Kështu vazhduan të jetojnë në një realitet rrëshqitës, i kapur momentalisht nga fjalët, por që do ikte pa kompensim kur të harronin vlerën e germës së shkruar”.

Kështu shkroi Gabriel Garcia Marquez më 1967, duke paralajmëruar se saktësisht pas 51 vjetësh do të kemi harruar vlerën e germës së shkruar dhe gati të çdo gjëje që përshkruan ajo.

Silvio

E pash Silvio Berlusconi në Elbasan. Më saktësisht, në Met-alurgjik të Elbasanit.

Metalurgjiku ishte një punë kolosale e socializmit sovjetik, kinez dhe shqiptar.

E kërkonte një vend kaq kolosal një figurë kaq kolosale si Silvio.

Edhe Silvio kërkonte që të shënohej, me praninë e tij, se ardhmëria të cilën e simbolizon ai ndërtohet mbi rrënojat e të kaluarës kolosale.

Working Memory

Kujtesa fillon menjëherë.

Shqisat tona kapin ngjyra dhe aroma, tinguj muzikor dhe bërtitma, ftohje gjuhe nga akulli dhe djegie dielli në supe dhe që të gjitha këto shndërrohen në kujtesë imediate.

Truri i njeriut i proceson në dy mënyra. Menjëherë trajtohen nga “working memory”, kujtesë e punës apo atë që edhe njohësit bazikë të kompjuterit e njohin si RAM memorie – pra, memorjen që ruan informatën e marrë nga sensorët stimulues. “Një pjesë e memorjes së punës, që gjendet në pjesët e poshtme të trurit, e mban informatën ndërsa pjesët e sipërme të trurit manipulojnë dhe përditësojnë përmbajtjet e ruajtura. Informata që është e ruajtur në memorjen e punës përcakton se në çka jemi të përqendruar momentalisht”, thotë doktori David Kessler, në *Capture: A Theory of the Mind*.

Memorja e punës është e nevojshme për të mësuar. Kur fillon të mësosh ngasjen e veturës, duhet të mendosh në formë aktive për të gjitha veprimet e nevojshme, gjë që nënkupton procesim të shumë informatave, rrjedhimisht përdorim të madh të memorjes së punës. Njëherë kur të mësosh, vozitja nuk kërkon kaq shumë procesim informatash, rrjedhimisht edhe vendos më pak kërkesë për memorje pune.

Sislej Xhafa është një lëvizje e përditshme që kërkon vëmendjen e memorjes së punës. Është si një kalimtar që të del qëllimisht para veturës kur e ke semaforin e hapur. Është një dorë që futet në xhepin tënd në *Piazza della Signoria*, është një puthje skinheadsi, është një futbollist shqiptar me pavijonin e tij ambulant; në bursë është shpërndarësi i aksioneve të kujtesës që fillon menjëherë.

Memory Begins Immediately

— Veton Surroi

On Sislej Xhafa's
exhibition
*love you without
knowing*,
The National
Art Gallery of
Kosova,
Prishtinë,
July 6, 2018

The Breast

Love is giving, and giving begins from the breast.

It is an existential obligation originally, a mother's necessity to create the possibility of a biological survival of the infant. For a non-mammal mother, a flying bird, it is a piece of food picked up off the ground surface, or under a water surface, brought to an infant and chopped in order to enable absorption in the organism.

Mother has to give so as to create life. An infant who receives life calls it (when it would find the words for them) survival and love.

Thus, survival and love unite.

This is called altruism. In the phylogenetic evolution of animals it reaches to the most advanced animal – the man. Altruism is inborn to a man from the moment it heads for mother's breast.

It is so inborn that in his code of behavior, the giving, the gift, fulfills two basic needs.

Fulfills the inner need, an inborn one, for giving. And also fulfills the inner need for security: giving is the primal form of creating security. Monkeys who do not want to fight other monkeys' tribes for forest resources give them some of their fruits.

Marco Polo and other adventurers in distant lands always carry with themselves gifts for unknown peoples: they are signs for instigating a primal sense of altruism.

It is easy for the mother and the child to establish an altruistic relationship. It is easy for the family. It is easy for the nation. It is easy for the traders who offer gifts as an entry into a trade relation. It is easy for the members of a nation. Mother's altruism is a reward of milk for the child, it is food and clothing for the family, it is a trade contract for business-people, it is security for the nation. The reward exists in all.

However, loving without knowing - without knowing whom, or what, or even without knowing you are doing it –

this is quintessential altruism. Something like a breast for all the infants of the world, a beak for all the planetary birds.

Movement (1)

Man is born with the ability to move long distances from the moment he was forced to chase animals for food. Other animals have understood early that the animal called the man is a danger to them and have used their speed and endurance to save themselves from becoming food. Man created weapons for gaining advantage, however still needed fast legs and long distance endurance for catching prey.

Man is born with the need to stay in a place once he discovers that wild plants are ennobled into wheat which then becomes bread. From the bread creates settlement, collectivity, borders and powers which redistribute surplus wheat and bread.

Man has long been in search of understanding which of the two he really is. Is he the one who travels long distances with the strength of his legs and the invention of weapons in search of new hunting grounds, food for the long winters and the family that must survive it? Or is he the one that sows and reaps creating a harvest of surplus in which he agonizes over how to put it to best use?

The brink on which the man finds himself, the one of the fast legs and the other of the need for remaining in a place, helps him make an epochal discovery, a *Rocket Ship* (2011), something which will create the possibility of the fast movement in situ.

Movement (2)

One of the people that gave up hunting but did not want to grow the wheat decided he would live by collecting stories. Stories were necessary as signs for hunters and signs for

farmers. The story and the storyteller made it known when the harvest would take place and to what extent the crops lay. Hence they invented the future time and geography.

However you turn the story, toward the past or the future, storyteller's turned to geography.

Anyhow the story, towards the past or the future, the storytellers would turn to geography.

One day the stories and the storytellers were crammed inside a track's tarpaulin, type *Concetto in Exile*, model 2016.

Movement (3): *Barka* 2011

He is dressed in his best clothes because we, the people who flee, dress our children in the best clothes. When we flee we want those who wait for us to see us at our best. We do not want them to see us as escapees. We want them to see us as we are, even better than we are. We do not want to be dishonored. We do not want to be dishonored even when we know we will not eat, will not drink, will not know where we will sleep. We want them to know that when we fled we kept a part of a self with us which we did not abandon. We have left many other things. Sometimes the hope, sometimes the joy, sometimes the force to lead us to the good.

When we dress him in his best clothes we want them to know we care about our people, even this way, even when we flee. We want them to know that when we sometimes abandoned the hope, sometimes the joy, sometimes the force to lead us to the good, we did not abandon ourself. The one we have regained in the morning, when we have dressed our son in the best clothes.

Because they, the best clothes, will protect him from the twilighting sky, a sea wave, evil spirits.

Will protect him from fate.

Will wish him well. The one we, the fleeing people, have lost.

They, the best clothes, will carry him to the other coast, the one which is completely different from this one we live in: to the other coast where the weapons do not awaken you, nor the empty stomach, or the frightening dream of parents

that tomorrow will not come.

We, the people that fled, the people that flee, we the Albanians, and all the others like us, have lost one of us today. We had dressed him in his best clothes. We knew he would challenge the darken sky, and the waves, and the evil spirits.

This much we knew.

Whoever wants to translate this into other languages can do so. Tonight I had the feeling that the death of a child on the coast of that area, the unprotected one, sounded Albanian, so Albanian that I could not translate it, so Albanian that I barely ended it; so Albanian that the tears do not let me write it in another language.

(Death of Aylan Kurdi, September 2, 2015)

Movement (4)

The hunting man and the wheat man have the consecration in common. The hunting one discovers that there is water and gazelles, and a lack of other hunters, and believes that he was blessed by the gods for this gift. Erects a totem and deems that the land, proclaimed sacred by now, will be protected by the image of the Lord which the Man, called the artist, has created with such mastery.

The wheat man believes that the crops which come to him year after year not only could have been an outcome of his work, but the Lord's also, who provided so many rewards to a sincere committedness. And it is obvious that it has to be proclaimed as a Holy land, with the totem which will protect this Holy land from insects, hailstorms and strangers.

Holy lands are so holy they are defended by war and conquered by war. The ones defended remain with the totems they already had, the ones conquered or liberated – depending on the perspective, have new totems, and consecrate anew.

It is not known where remained those heads, bones, pieces of hair and limbs, shoes and baby bottles, jeans and jackets firstly grabbed with an urgency of fleeing – members of hunters and farmers, whose holy land was consecrated by the others.

New consecrators need not to have anything: neither bodies, heads, bones, pieces of hair and limbs, shoes and baby bottles, jeans and jackets firstly grabbed with an urgency of fleeing, nor a memory of bodies, heads, bones, pieces of hair and limbs, shoes and baby bottles, jeans and jackets firstly grabbed with an urgency of fleeing.

In the end, there exists a new totem created to replace the ones of the holy lands, Office for *Lost and Found* (2017). One can deposit heads, bones, pieces of hair and limbs, shoes and baby bottles, jeans and jackets firstly grabbed with an urgency of fleeing.

There is also a telephone for memory requesting, but the last time checked it did not have a signal, a failure not temporary alike life.

Cows

In Gabriel Garcia Marquez's *One Hundred Years of Solitude*, the Buendia family discerns that it has started to forget the names of the ordinary things it uses in everyday life. And they introduce practicing a method in the entire house, imposing it to the whole village afterwards. One of them "marked everything with its name: table, chair, clock, door, wall, bed, pan. He went to the corral and marked the animals and plants (...) Little by little, studying the infinite possibilities of a loss of memory, he realized that the day might come when things would be recognized by their inscriptions but that no one would remember their use. Then he was more explicit. The sign that he hung on the neck of the cow was an exemplary proof of the way in which the inhabitants of Macondo were prepared to fight against loss of memory: This is the cow. She must be milked every morning so that she will produce milk, and the milk must be boiled in order to be mixed with coffee to make coffee and milk. Thus they went on living in a reality that was slipping away, momentarily captured by words, but which would escape irremediably when they forgot the values of the written letters."

Thus wrote Gabriel Garcia Marquez in 1967, predicting exactly that after 51 years we would have forgotten the value

of a written letter and of almost everything it describes.

Silvio

I saw Silvio Berlusconi in Elbasan. More precisely, at the Elbasan Metallurgical Plant.

Metallurgical Plant was a colossal endeavor of the Soviet, Chinese and Albanian socialism.

Such colossal place demanded such colossal figure as Silvio.

And Silvio demanded to be pointed out, with his presence, that the future he symbolizes is founded on the ruins of a colossal past.

Working Memory

Memory begins immediately.

Our senses catch colors and aromas, musical sounds and shouts, tongue freezing from ice and shoulders' sunburns, and all these turn into an immediate memory.

The human brain processes them in two ways. They are promptly processed by the "working memory," or what people with a basic knowledge of computers know as RAM memory – memory which houses the information received from sensory stimuli. "One part of working memory, lodged in the lower parts of the brain, holds the information while the higher parts of the brain manipulate and update the stored contents. The information that is currently being held in working memory determines what we are focusing on presently", says Dr. David Kessler in *Capture: A Theory of the Mind*.

Working memory is necessary for learning. When you first learn to drive you need to make an active effort for all the steps necessary, which means processing of many information, and consequently a higher usage of working memory. Once you have learned it, driving does not require so much information processing, therefore it puts less demand on working memory.

Sislej Xhafa is an everyday movement which requires the attention of working memory. He is like a pedestrian who

deliberately appears in front of the car while the traffic light is green. He is a hand stuck into your pocket in *Piazza della Signoria*, a skinhead's kiss, an Albanian football player with his mobile pavilion; in a stock-exchange he is a dealer of the stocks of memory which begins immediately.

Arti emancipues i Sislej Xhafës – Ftesë me guxu

— Eli Krasniqi

Hera e parë që hasa artin e Sislej Xhafës ishte para disa vjetësh, kur isha tue ba një kërkim për një punim rreth shtetësisë së kontestueshme. Kjo ishte puna *Padiglione Clandestino* (Pavijoni Klandestin), më 1997, në Bienale të Venedikut, ku Xhafa ishte shndërru në një pavijon që përfaqësonte Shqipërinë. Ai po kontestonte dhe kritikonte kushtet e legjitimitetit të pjesëmarrjes së artit nga vende të caktueme, dinamikat e asaj që ai e quen “legales së detyrueme” dhe “ilegales së detyrueme”. Vite më vonë, Xhafa përfaqësoi Shqipërinë dhe Italinë. Më 2017, përsëri në Bienale të Venedikut, Xhafa përfaqësoi Kosovën me “p” (E humbun dhe e gjetun). Brenda kontekstit shqiptar, nëse shikohet prej një aspekti kronologjik e linear, kjo dekadë e artistit dhe artit të tij, ndër tjera, nxjerr në sipërfaqe konstalacionet politike, politikat identitare, por edhe dëshmon për fluiditetin e tyre.

Në ekspozitën e Bienales së Venedikut, *lost and found* (2017) ndodh në një hapsinë të zbrazët që ka një tip kabine prej paleta druri dhe një telefon në parmakun e kësaj kabine. Telefoni i moçëm nuk cingrron, hesht. Cingrrima ngel vetëm në imagjinatën tonë, apo në shpresën e atyre që presin. Njësoj kështu hesht edhe ndërgjegjja njerëzore dhe politike për të gjithë njerzit që u rrëmbyen dhunshëm nga forcat serbe në luftën e fundit në Kosovë. Xhafa përmes hapsinës së zbrazët, heshtjes dhe probabilitetit (të një thirrjeje) paraqet agoninë e pritjes. Zbrastësia e hapsinës ku rrinte paleta e drurit me telefonin e heshtur për mu reflekton pikërisht atë ndjenjë që ma të dashtunit e personave që mungojnë duhet ta kenë – qetsinë zhuritëse kur bota realisht gjallon, por për ata bota reduktohet në një telefon që nuk cingrron. Një shpresë, e vagullt, për një lajm që nuk vjen, gati dy dekada tashmë. Ndërkaq *Tellalli* heshtjen brenda e then në thirrje jashtë, të të gjithë emrave të personave që mungojnë. Xhafa ndërthur hapsinat private me publike, thirrjen e heshtjen, agoninë dhe shpresën.

Arti i Xhafës flet përtej kontekstit shqiptar, apo këtë kontekst e fut në shumësinë e konteksteve tjera sociale,

ekonomike, kulturore e politike, dhe aty e nxjerr përvojën njerzore, pabarazitë dhe shtypjen. Xhafa e bën këtë duke hedhë dritë në pjesë të botës së zhvillume, “të përndrituna”. Aty ku moderniteti bahet sinonim me ashpërsinë e jetës së përditshme, e veshun me rrobe profesionale, ku të drejtat janë selektive dhe bahen çashtje privilegjesh. Por, ai njikohësisht e hedh këtë dritë edhe në pjesë të botës të cilat, në hierarkinë e randësisë se çka përban lajm në mediat botnore, nuk mrrijnë vendin e meritum. Ai nxjerr në sipërfaqe realitete ku pushtetet i vejnë grupet e margjinalizume – refugjatët, azilantët, mi-grantët.

Ekzili asht konditë njerzore, pasojë e pabarazive ekonomike, politike dhe klasore. Edward Said, në Reflektimet për Ekzilin, e përshkruen atë si “nji e çarë e pashërushme midis qenies njerzore dhe vendit të origjinës, midis vetes dhe shtëpisë së vërtetë: pikëllimi esencial i [së cilit] kurrë nuk mundet me u kapërcy”. Ai konsideron që edhe pse letërsia e historia hera herës e kanë romantizu ekzilin dhe triumfet e mundshme të tij, në fakt, tana këto nuk kanë qenë ma shumë se përpjekje me tejkalu dhimbjen e ndamjes. Asht kjo ndamje pra, kjo shkëputje, lëvizje e detyrueme prej nji vendi në vendin tjetër, që e karakterizon artin e Xhafës. Dhe jo thjesht përmes simbolikës. Arti i Xhafës mue më sjell dimensione të reja e të panjoftutna përjetimesh që shtrojnë shtigje emancipimi. Xhafa e ban këtë përmes privates e intimes, atyre dromcave të vogla të së zakonshmes në dukje, por shpesh luks për të shtypunit, siç mund të jetë gjumi i qetë për shumicën e migrantëve apo refugjatëve (*Future of Old*).

Përmes barkës së marueme me këpucë grash, fëmijësh e burrash (*Barka*, 2011), e cila asht thirrje për me i ditë e me i njoftë fërkemt e kësaj kondite të të shtypurve kudo, rrugëtimet e tyne që nuk mbarojnë.

Asht thirrje për me guxu. Me ua heqë kuajt heronjve, me i kthy në tokë prej ku ata kanë fillu (*Giuseppe Garibaldi*, 2007). Grand narrativat e kombit dhe shtetit rëndom thuren

me kultin e heronjve dhe sakrificës së tyre, dhe në vendet si tonat kjo nuk përkthehet në liri, por pretekst për dominim dhe legjitimim të shtypjes. Xhafa me artin e tij ua heq pretekstin. Ai na fton me guxu që me e kuptu që pushtetet dominuese dhe shtypëse, sado të mëdha e të fuqishme duken, në fund, ato janë të marueme prej zalli (*Silvio*, 2010).

Emancipatory Art of Sislej Xhafa—An Invitation to Dare

— Eli Krasniqi

The first time I came across Sislej Xhafa's art was several years ago, while I was doing research for a paper on contested statehood. It was the work *Padiglione Clandestino*, in 1997, at the Venice Biennale, in which Xhafa was transformed into a pavilion representing Albania. He was contesting and criticizing the legitimacy terms of participation of art from specific countries, the dynamics of what he calls “forced legality” and “forced illegality.” Years later, Xhafa represented Albania and then Italy. In 2017, in Venice Biennale again, Xhafa represented Kosovo with “lost and found.” Within Albanian context, if viewed from a chronological and linear aspect, this decade of the artist and his art brings up political constellations, identity politics, but testifies to their fluidity also.

In the Venice Biennale exhibition *lost and found* (2017), there is an empty space with a cabin made of wooden pallets, and a telephone on a cabin's handrail. The old telephone does not ring, it remains silent. Ringing stays in our imagination only, or in the hope of those who wait. Likewise silent is the human and political consciousness concerning all the people who were violently abducted by the forces during the last war in Kosovo. Through empty space, silence and probability (of a call), Xhafa displays the agony of waiting. The emptiness of space where the pallet is placed with a silent telephone to me reflects precisely the feeling which the dearest persons of the missing people must have – a scorching serenity whilst the world lives on, although to them the world is reduced to a telephone that does not ring. A vague hope for the news which does not arrive, for almost two decades now.

Meanwhile, *Town Crier* breaks the silence with an outer calling of all the names of the people missing. Xhafa intertwines private and public spaces, calling and silence, agony and hope.

Xhafa's art speaks beyond the Albanian context, or includes this context in the multitude of other social, economic, cultural and political contexts, from where it derives

human experience, inequalities and oppression. Xhafa does this by shedding light into parts of the developed world, the enlightened ones, where modernity becomes a synonym for harshness of the everyday life, dressed in professional apparel, where the rights are selective and become an issue of privileges. Nevertheless, he simultaneously sheds this light in the parts of the world that do not get a deserved place in the importance hierarchy of what constitutes a news in the world's media. He unearths realities in which powers are constituted by marginalized groups: refugees, asylum seekers, migrants.

Exile is a human condition, a result of the economical, political and class inequalities. Edward Said, in *Reflections on Exile*, describes it as “the unhealable rift forced between a human being and a native place, between the self and its true home: its essential sadness can never be surmounted.” He considers that while it is true that literature and history contain heroic, romantic, even triumphant episodes in an exile's life, these are no more than efforts meant to overcome the crippling sorrow of estrangement. This estrangement, this detachment, a forced movement from one place to another, characterizes Xhafa's art. And not simply symbolically. Xhafa's art brings me new dimensions of unknown experiences that floor emancipatory paths. Xhafa does this through the private and the intimate, those small bits of seemingly usualness, but often a luxury for the oppressed, such is the quiet sleep for the majority of migrants or refugees (*Future of Old*).

A boat made of women's, children's, and men's shoes, (*Barka*, 2011), is a call for knowing and recognizing the footprints of this condition of the oppressed everywhere, their never-ending journeys.

It is an invitation to dare. To take away the horses from the heroes and bring them back to the ground off they commenced (*Giuseppe Garibaldi*, 2007). Grand narratives of nation and state are usually woven from the cults of heroes and their sacrifices, and in places like ours this does not translate into freedom, but to a pretext for domination and oppression legitimizing. Xhafa takes away their pretext with his art. He invites us to dare understand that dominating and oppressive

powers, however huge and powerful they seem to be, are made of sand ultimately (*Silvio*, 2010).

Rebel me arsye

— Blearta Jashari



*Besimet tua bëhen mendimet tua,
Mendimet tua bëhen fjalët tua,
Fjalët tua bëhen veprimet tua,
Veprimet tua bëhen shprehitë tua,
Shprehitë tua bëhen vlerat tua,
Vlerat tua bëhen fati yt.¹*

Mirë se vini, Benvenuto, Bienvenue, Welcome... në universin e mrekullueshëm të artistit Sislej Xhafa. Emri i Xhafës është duartrokatur në botën e Artit Vizual Bashkëkohor gjatë 20 viteve të kaluara si rebel dhe artist autentik.

Ata prej jush që ende nuk dinë për artistin, miqësisht janë të ftuar për herë të parë të zhyten në të panjohurën. Dy vepra më bien ndërmend për t’ju njoftuar me gjuhën dhe universin e artistit, të mirënjohurat *Pavijoni Klandestin (Padiglione Clandestino)* dhe *Autoportreti (Self-Portrait)*.

Artisti për herë të parë doli në skenë në vitin 1997, në Bienalen e Venedikut, me veprën *Pavijoni Klandestin (Padiglione Clandestine)*. Sislej Xhafa vetvetiu u bë Pavijon Jozyrtar Shqiptar lëvizës në të mirënjohurin Giardini. I paftuar, rrjedhimisht ilegalisht, ai arrin të intervenojë në mënyrë tejet delikate dhe gazmore, e kësisoj të nxit pyetje. I veshur si futbollist i kombëtares së Shqipërisë, me fanellën e ngjyrosur në trup, brekë të zeza dhe çorape të gjata të zeza, me një flamur të vogël të Shqipërisë të vendosur në çantën e shpinës ku e mban një radio dore e cila transmeton ndeshje futbollit, artisti i mëshon me këmbë topit duke i ftuar vizitorët të përfshihen në lojë. Të paditur për qëllimet e vërteta, vizitorët pavetëdijshëm bashkëpunojnë në këtë “veprim ilegal”. Intervenimi i vogël i Xhafës ngriti pyetje për (problemin me) mospërfaqësimin në ekspozitën më të madhe dhe më të famshme të artit bashkëkohor në botë të shumë kombeve që janë jostabile ekono-

¹ Mahatma Gandhi

mikisht dhe politikisht.

Si është e mundshme që Luksemburgu, me 300 mijë qytetarë, ta ketë pavijonin e vet në Venedik, përderisa shtetet si India, Mongolia, Shqipëria, Sudani dhe shumë të tjera, ende anashkalohen? Artisti, me shfrytëzimin e futbollit dhe mekanizmave të tij si metaforë, duket se bën lutje për fer-plej në botë (të artit). Lutje për të pasur pikënisje të barabartë dhe të përbashkët të sheshuar të nisjes. Fer-plej nënkupton më shumë sesa vetëm respektim i rregullave; përfshin nocionet e miqësisë, barazisë, respektit për të tjerët dhe korrektësisë të vërtetë (sportive). Është mënyrë e të menduarit, jo vetëm sjellje.

Koncepti “fer-plej” zbulon dhe thekson problemet që kanë të bëjnë me luftën kundër mashtrimit, artit të hileve gjatë respektimit të rregullave, dhunës (fizike dhe verbale), si dhe pabarazisë së mundësive. Hulumtimi dhe ngritja e pyetjeve mbi këto çështje vërtet është shndërruar në shenjën dalluese të Sislejt.

Rrjedha e vet jetës së artistit, i cili vjen prej Kosovës dhe migron në Perëndim në vitet e 1990-ta, e ka bërë të vetëdijshëm për atë se sa të huaj janë njerëzit kur ti je i huaj. Ana tjetër nuk është aq mikpritëse sa ke shpresuar. Dante e ka përshkruar shumë mirë këtë ndjenjë në “Parajsën” e tij, kur ka shkruar:

 *Ti do lesh çdo gja, që ma nevojë
pat shpirti yt; e para ka me t’shtypë
kjo zhgjetë, që n’ty mërgimi do drejtojë.*

*Ti do provosh sa ka përbrenda krypë
buka e huej, sa shtegu asht i vështirë
n’shkallë të hueja me hypë edhe me zhdrypë.²*

² Komedia Hyjnore”, përkthim i Pashko Gjeçit, 1961

Kur migroni, bëheni dëshmitarë sa armiqësorë mund të jenë shoqëria dhe njerëzit ndaj jush për shkak se jeni “tjetri”, kërcënimi. Shumëçka vendoset me frikë, paragjykim dhe racizëm. Nuk ndjeheni bash i mirëseardhur. Në anën tjetër, largimi nga rrënjët gjithashtu ju konfronton me vetveten. Vënia në pikëpyetje e identitetit, kombësisë, kulturës... realisht bëhet pjesë e qenies suaj. E kuptoni se asgjë nuk është e fiksuar: asgjë nuk është e veçuar, të gjitha janë të ndërvarura; gjithçka është në stilin e dyndjes. Lëvizja është gjendje e tranzicionit, edhe fjalëpërfjalshëm – si ndryshim i vendndodhjes – por, gjithashtu edhe si ndryshim në kuptim, emocion dhe mendim. Për Xhafën, ndryshimi është i pandashëm prej sjelljes njerëzore dhe jetës në përgjithësi. Duhet të konsiderohet si forcë pozitive në jetë. Mirëpriteni dhe përqafojeni krahëhapur, sepse *“ndryshimi është një realitet i patejkalueshëm, i parezistueshëm dhe i vazhdueshëm i universit. Për ne, kjo e bën të jetë realiteti më i fuqishëm (...) Çdo gjë që prekni, Ju Ndryshoni. Çdo gjë që Ndryshoni ju Ndryshon. E vërteta e vetme e përhershme është Ndryshimi”*.³ Ad infinitum.

Khafa duket që udhëhiqet prej vlerave Humaniste, siç janë drejtësia, e vërteta dhe drejtshmëria. Arti i tij vepron me një urgjencë të caktuar, duke e marrë realitetin si pikënisje të tij. Atij i interesojnë gjërat që ia nxisin ndjenjën e trazimit të brendshëm. I udhëhequr nga intuita, ai zgjedh subjekte të padyshimta dhe pikëllime të pakuptueshme për t'i sfiduar qëndrimet rigjide dhe ta vejë në pikëpyetje status quo-në dhe/ose shoqërinë e marginalizuar. Rrëfime të cilat edhe do të mund të qëndronin sekrete, të harruara ose të fshehura... Opusi i Xhafës na ofron metafora, duke krijuar një prerje me shoqërinë tonë të luajtur mendsh. Ato janë ftesa për të reflektuar mbi standardin e një rregulli më të lartë moral, i cili i ndërlihd veprimet e të gjithë njerëzve. Quajeni aksion antropologjik universal.

“Hulumtimi im dhe ndjeshmëria ndaj punës sime burojnë prej gjendjes njerëzore pa vija kufitare (...) Besoj se roli i artistit është që me estetikë t'i potencojë kompleksitetet në çdo sho-

³ Octavia Butler

qëri. Nuk dua të them se të gjitha veprat e mia janë specifike ndaj vendeve të caktuara. Por, duhet ta kuptoni që, për mua, vlera e qenies njerëzore është vlera më e rëndësishme në të cilën besoj. Kur e kuptojmë vlerën e qenies njerëzore, e respektojmë atë vlerë dhe jemi të aftë të bëjmë veprim magjik. Puna ime është e ndërlidhur me shoqërinë si universale. Arti është gjuhë universale... Unë, si artist, nuk e di çfarë do thotë fjala "artist". Mirëpo, e di një gjë: që jam qenie e ndjeshme njerëzore dhe përpiqem të shtroj pyetje për gjërat që kanë rëndësi në jetën e përditshme, të manifestoj dhe të materializoj ndogjë magjike. Ndonjë lloj të ri të përjetimit të ndryshëm. Besoj se arti është demokracia e vetme e mbetur, e cila ofron hapësirën që kërkohet për udhëtim vetmitar drejt paqes. Dhe ajo magji – prej të cilës kurrë nuk do të duhej të hiqnim dorë – ai tip i lirisë, është duke u marrë peng nga gjithfarë autoritete formale".

Pavijoni Klandestin (Padiglione Clandestino) tash për-bëhet prej një imazhi të varur në mur galerish. Aksioni ishte kapur dhe përjetësuar në formë të fotografisë. Shfaqet me kornizë të madhe të artë, që t'i kujton pikturat klasike. Pavijoni Shqiptar është fakt.

Vepra e dytë e cila na jep më shumë njohuri për reper-torin e artistit është *Autoportreti (Self-Portrait)*, (2003).

Autoportreti gjithmonë ka qenë me interes të posaçëm për historinë e artit, i konsideruar si vepër me rëndësi të veçantë. Mendohet se qëllimi i vetëm i autoportreteve është të na sjellin në kontakt me shpirtin e artistit. Prandaj, shihen si pasqyra të jetës së dikujt. Nëse e shfletojmë katalogun e autoportreteve në historinë e artit, ballafaqohemi me vepra pompoze, lozonjare ose thjesht të këndshme; pretencioze me sukses, ose duke u kënaqur me vetëpërqeshje; duke e promovuar një estetikë të re, ose duke e shënjuar ndonjë instancë specifike në jetën e artistit.

Autoportreti i Xhafës përbëhet nga një shalqi i vendosur në pedestal. Fruti, i pjekur, mban statusin e veprës artistike. Artisti e shndërron atë në objekt të reflektimit, duke hapur nivele të reja të kuptimësimi të tij.

Vetëm dy kritere duhet të përmbushen nga kjo vepër:

fruti duhet të vijë nga një shtet i ngrohtë dhe duhet të konsumohet, ose të zëvendësohet, me kohë. Nëse jo, natyra do ta bëjë të veten dhe fruti do të fillojë të kalbet.

Nëse gërmojmë pak më thellë në “shalqirin”, kuptojmë se ky frut ka histori të gjatë. Ka lëvizur nga njëri kontinent tek tjetri, duke u shndërruar në produkt të vërtetë të globalizimit. Në kohën e sotme mund të vijë nga cilido vend, me kusht që kultivohet në tokë të ngrohtë. Sa më i ngrohtë dielli, aq më i shijshëm fruti. Shalqiri gjithashtu ka shumë fara të cilat dëshmojnë fertilitet. Shalqiri është objekt shumë i bukur si i tillë, me tone të përsosura të të gjelbrës dhe të kuqes. Përbëhet prej 90 për qind ujë, gjë që shpesh e bën të hahet si etjeshues. Në viset jugore, shalqiri zhytet në ujë të ftohtë gjatë gjithë ditës, në mënyrë që efekti i etjeshuarjes të maksimalizohet. Mund të vazhdojmë edhe më tej... Metafora për njeriun e kohës moderne, ose edhe për shoqërinë (e globalizuar), mund të bëhet me lehtësi. Çlirimi i procesit të asocioneve dhe shtimi i kuptimeve është konstantë në veprën e Sislej Xhafës. Kjo është e mrekullueshmja e saj: si spektatorë, kurrë nuk jeni pasivë. Motoja e Duchamp-it: “Shikuesi është ai që e krijon veprën artistike”, është plotësisht e vërtetë për veprën e Xhafës. Magjia e tij qëndron në aftësinë e krijimit të hapësirave ku objektet e zakonshme transformohen në vepra artistike të ngarkuara, shumëkuptimore, që ju ftojnë të dialogoni. Artisti e konsideron rol të tij t’ju ndihmojë t’i përjetoni “dimensionet e ndryshme”, ta hap një gjendje më kontemplative dhe ta ndryshojë gjendjen mendore të individit, ndërkohë që parashtron pyetje universale. Shfrytëzon poezinë vizuale të një piktori surrealist, vepron me urgjencën e një ekspresionisti. Sislej e krahason artin e tij me aktin e hapjes së dritares në një dhomë të mbyllur. Puhia që hyn e freskon ambientin. Njëjtë si një puhi, vepra e tij është përvojë e cila ofron hapësirë frymëmarrjeje nga rëndesa e jetës së përditshme. Gjuha e tij vizuale nuk mund të vendoset në vetëm një kategori. Ajo gjithmonë ka diçka të freskët dhe të re. Vepra e tij e ka poetikën e vet dhe estetikën e vet. Vjen prej pasioneve të cilat janë shtysat e tij si njeri. Është materializim i Mendimeve. Secila vepër mbart rrëfimin e vet, arsyen e përmbajtjes dhe materialin.

Filloni udhëtimin nëpër opusin e Sislej Xhafës duke e pasur këtë në mend:



Nëse i mbyllni sytë dhe shikoni drejt botës suaj të brendshme - dhe besoj se gjëja më mirë që mund ta bëni është t'i mbyllni sytë dhe të shikoni brenda - ky është syri i brendshëm, ndërsa syrin tjetër duhet ta përqendroni në realitet, në atë që po ndodh në botë. Nëse ia dilni ta bëni një lloj sinteze të këtyre dy botëve të rëndësishme, arrini tek rezultati që mund të konsiderohet si sintezë e jetës objektive me atë subjektive.⁴

Nëse jeni në gjendje ta bëni këtë, do të mbeteni me po atë ndjenjë të mrekullimit që e përjeton fëmija derisa i shikon fluskat. Gjuha vizuale e Xhafës është e aftë ta bëjë ngritjen e shkathtësive tuaja asociative dhe mendjes suaj kreative.

Me fjalët e tija:



Unë i vë në pikëpyetje gjërat e rëndësishme për ne. Pra, çfarë ka rëndësi për ne? Jeta e përditshme, çështjet e padrejtësisë sociale, ilegaliteti i detyruar, raportet gjeografike, imigrimi – në cilëndo formë. Sido qoftë, unë nuk jam ekspert në asnjërën fushë: nuk jam piktor i mirë, nuk jam skulptor i mirë, nuk jam... asgjë i mirë. Por, unë shtroj pyetje.⁵

“Sjelljet e njeriut janë pasqyrë në të cilën e shfaq portretin e tij”, ka thënë Goethe. Nëse i shikojmë sjelljet e artistit, ballafaqohemi me një njeri i cili udhëhiqet prej standardeve të larta morale. Ai vepron si fisnik dhe lufton kundër padrejtësisë, duke e shfrytëzuar skenën e tij për t'i dhënë zë të padëgjuarës dhe bërjes së “të padukshmes” të dukshme. Konsiderohet si rebel, vazhdimisht duke sfiduar status quo-në në kërkim të së vërtetës.

4 Max Ernst

5 Sislej Xhafa

Ndonëse e mohon, Xhafa është artist autentik. Ash-tu si çdo krijues tjetër i mirë imazhesh, fuqia e tij qëndron në gjuhën e tij vizuale. E sfidon vetveten për të sjellë vepër arti të freskët dhe inovative. Çdo çështje që zgjedh për ta prezantuar është materialisht befasuese. Vizualisht, ai e ka një mënyrë të vendosjes në skenë të përshtypjeve të anës së errët të jetës së përditshme, duke i lehtësuar ato, për ta lënë shikuesin me ndjenjën e mahnitjes.

Prania në ekspozitën e Xhafës do të jetë përvojë e përfshirjes totale, prandaj unë ju inkurajoj t'i shfrytëzoni të gjitha shqisat tuaja. Do ta shijoni fuqinë kreative të mendjes suaj. Mbani në mend këtë:



Çka është liria për ty dhe si e definon atë?

Çka është identiteti për ty?

Si e definon dhe çka është arti bashkëkohor për ty?

dhe

Elevohuni....

“Njëherë e pyeta zogun, si është e mundshme të fluturosh në këtë gravitet të errësirës?”.

U përgjigj,

*‘Dashuria më lartëson’”.*⁶

Rebel With a Cause

— Blearta Jashari

“Your beliefs become your thoughts.
Your thoughts become your words.
Your words become your actions.
Your actions become your habits.
Your habits become your values.
Your values become your destiny.”¹

Mirësevini, Benvenuto, Bienvenue, Welcome... to the wonderful universe of the artist Sislej Xhafa. Xhafa's name has been applauded in the world of Contemporary Visual Art during the past twenty years as a rebel and artist *pur sang*.

Those of you not familiar with the artist, are kindly invited to take a first dive into the

unknown. Two works come to mind to introduce you to the artist's language and universe, the well known *Padiglione Clandestino* and *Self-Portrait*.

The artist first came to the stage at the 1997 Venice Biennale with a work entitled *Padiglione Clandestine*. Sislej Xhafa himself acted as the mobile Unofficial Albanian Pavilion in the well-established Giardini. Uninvited, therefore illegally, he succeeds to intervene in a very subtle and playful way, only to raise questions. Dressed as an Albanian national soccer player, with the T-shirt body-painted, black shorts and long black socks, a little Albanian flag stuck in a backpack that holds a portable radio transmitting a soccer game, the artist bounces a soccer ball, inviting the visitors around him to engage in a game of ball. Unaware of the real intention of it, the visitors unconsciously cooperate in this “illegal action”. Xhafa's little intervention raised questions on the (issue of the) non-representation of many economically and politically unstable nations in the biggest and most well-known contemporary art exhibition in the world.

How come Luxembourg, with its three-hundred thou-

¹ Mahatma Gandhi

sand citizens, has its own pavilion in Venice, while states like India, Mongolia, Albania, Sudan and a dozen others are still left on the sideline? The artist, using football and its mechanisms as a metaphor, seems to be making a plea for fair play in the (art)world. A plea for an equal and common ground to stand on and start from. Fair play means more than just respecting the rules; it covers the notions of friendship, equality, respect for others and true (sports)manship. It's a way of thinking, not just a behavior.

The concept "fair play" reveals and points out problems concerning the fight against cheating, the art of trickery while respecting the rules, violence (both physical and verbal) and the inequality of chances. Investigating and raising questions on these issues has really become Sisley's trademark.

The flow of the artist own life, coming from Kosova and migrating to the West during the '90s, made him aware of how strange people are when you are a stranger. The other side is not as welcoming as you had hoped. Dante depicted this feeling very well in his "Paradiso" when he wrote:



You shall leave everything loved most dearly, and this is the shaft of which the bow of exile shoots first. You shall prove how salt is the taste of another man's bread and how hard is the way up and down another man's stairs.²

When you migrate, you witness how hostile society and men can be towards you because you are the "other", a threat. Much is ruled by fear, prejudice and racism. You don't really feel welcome. On the other side, leaving your roots also confronts you with yourself. Questioning identity, nationality, culture... truly becomes part of your being. You realize nothing is fixed; nothing is singular, all is interdependent; all is in a mode of flux. Movement is a condition of transition, both literally - as a change of location - but also through a shift in meaning, emotion and thought. For Xhafa, change is inherent to human behavior and life in general. It should be seen

2 Divine Comedy, Dante Alighieri

a positive force in life. Welcome it and embrace it with open arms, for *“change is the one unavoidable, irresistible, ongoing reality of the universe. To us, that makes it the most powerful reality (...). All that you touch, You Change. All that you Change Changes you. The only lasting truth is Change.”*³ Ad infinitum.

Khafa seems to be driven by Humanist values such as justice, truth and righteousness. His art acts with a certain urgency, taking reality as his starting point. Things that trigger his gut feeling are of his interest. Driven by intuition, he chooses unsuspected subjects and unfathomable sorrows to challenge rigid opinions and question the status quo and/or marginalized society. Stories that could just as well remain secret, forgotten or hidden... Khafa's oeuvre offers us metaphors, creating a break from our deranged society. They are invitations to reflect upon the standard of higher moral order that binds the actions of all men. Call it a universal anthropological action.

“My investigation and sensibility towards my work are derived from a human condition without borderlines (...) I believe that the role of an artist is to highlight complexities with aesthetics in any society. I don't want to say that all my works are site specific. But you must understand that for me the value of the human being is the most important value I believe in. When we understand the value of the human being we respect that value and we are able to make magical action. My work is related to society as a universal. Art is a universal language... I, as an artist, don't know what “artist” means, as a word. But I know one thing: that I'm a sensitive human being, and I try to question the things that matter to everyday life, to manifest and materialize something magical. Some new kind of different experience. I do believe that art is the only remaining democracy, which gives the space required for a solitary journey towards peace. And that magic—something that we should never give away—that kind of freedom is getting hijacked by all kinds of formal authority.”

Padiglione Clandestino now consist of a picture hanging on the wall of galleries. The action was captured and eternalised in the form of a photo. It is presented with a large golden frame, reminiscing classical paintings. The Albanian Pavilion is a fact.

The second work that gives us more insight in the artist's repertoire is *Self-Portrait* (2003).

The self-portrait has always been of particular interest to art history, viewed as a work holding special significance. The sole purpose of self-portraits, it is thought, is to bring us into contact with the artist's soul. They are therefore seen as mirrors to one's life. If we run through the catalogue of art history's self-portraits, we are faced with works being pompous, playful or merely pleasing; showing off success or indulging in self-mockery; advertising a new aesthetic or marking out a specific instance in the artist's life.

Khafa's *Self-Portrait* consists of a watermelon placed on a pedestal. The fruit, a ready-made, is granted the status of an artwork. The artist turns it into an object of reflection, opening new levels of meaning to it.

Only two criteria have to be met for this work: the fruit must come from a warm country and it has to be consumed or replaced on time. If not, nature will run its course and the fruit begins to decay.

If we dig a little deeper into "the watermelon, we learn that the fruit has a long history. It has been swifiting from one continent to another, transforming into a real product of globalisation. Nowadays it can come from anywhere as long as it grows on warm soil. The hotter the sun, the tastier the fruit. The watermelon also possesses many seeds, which indicates fertility. A watermelon is a very beautiful object in itself, with perfect tones of green and red. It consists for 90% percent of water, which makes it very often eaten as a thirst quencher. In the south, the watermelon is immersed in cold water throughout the day, so that the thirst-quenching effect can be maximized. We could go on... The metaphor for the modern day human, or even (globalized) society, is easily made. Unleashing a process of association and adding meaning is a constant in Sisley Khafa's work. That's wonderful about it: as

a spectator, you are never passive. Duchamp's motto "it is the beholder who makes pictures", is very true for Xhafa's work. His magic lies in his ability to create a space where familiar objects are transformed into charged, ambiguous artworks, inviting you to dialogue. The artist sees it as his role to help you experience "different dimensions," to open a more contemplative state and alter one's own state of mind, yet raise universal questions. Using the visual poetry of a surrealist painter, acting out with the urgency of an expressionist. Sislej compares his art with the act of opening a window in a closed room. The breeze that enters refreshes the ambient. Just like a breeze, his work is an experience that gives you breathing space from the heaviness of everyday life. His visual language cannot be pinned down to one category. It always has something fresh and new to it. His work has its own poetics and its own aesthetics. It comes from passions that drive him as a human. It is a materialization of Thoughts. Each work carries its own story, reason of content and material.

Take the journey through Sislej Xhafa's oeuvre with this in mind:

 *If you close your eyes and you look into your inner world, and I believe the best to do is to have one eye closed and to look inside, and this is the inner eye, and with your other eye you have it fixed on reality, what is going on in the world. If you can make a kind of a synthesis of these two important worlds, you come to a result which can be considered as a synthesis of objective and subjective life.⁴*

If you are able to do so, you will be left behind with the same feeling of amazement a child experiences while looking at bubbles. Xhafa's visual language has the ability to arise your associative skills and your creative mind.

⁴ Max Ernst

Put in his own word:

 *“I question things that matter to us. So what matters to us? Everyday life, matters of social injustice, forced illegality, geographical relations, immigration, in any kind of form. However, I am not an expert in any field: I am not a good painter, I am not a good sculptor, and I am not a good ... anything. But I do raise questions.”⁵*

“A man’s manners are a mirror in which he shows his portrait,” Goethe said. If we look at this artist’s manners, we are faced with a man driven by high moral standards. He acts like a knight and fights against injustice, using his stage to voice the unheard and make the ‘unseen’ visible. He is seen as a rebel, constantly challenging the status quo, seeking for truth.

Even though he denies it, Xhafa is an artist *pur sang*. Like any good image maker, his strength lies in his visual language. He challenges himself to bring forth a work of art that is fresh and innovative. Any matter that he chooses to present, is materially surprising. Visually, he has a way of putting impressions of the darker side of daily life to the stage, making them light, leaving the viewer with a sense of amazement.

Seeing a Xhafa show will be an immersive experience, therefore I encourage you to use all your senses. You will enjoy the creative power of your own mind. Take the following in mind:

 *What is freedom to you and how do you define it?
What is identity to you?
How do you define and what is contemporary art to you?*

and

Get lifted...

*"I once asked a bird, how is it that you fly in this gravity
of darkness?
She responded, 'love lifts me'."*⁶




Sislej Xhafa
woven soil, 2018

Tetë lopë Kosove / Eight Kosova cows
Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana










Sislej Xhafa
lost and found, 2017

Paleta druri, plastikë, telefon / Wooden pallets, plastic, phone
Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana








Sislej Xhafa
***Landscape L*, 2013**

Spirale të metalta dysheku / Stripped spring mattress
260 x 300 x 15 cm

Me konsideratën e artistit dhe Blain|Southern / Courtesy of the artist and Blain|Southern









Sislej Xhafa
***Merely*, 2005**

Gips / Plaster

53 x 106 cm

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana







Sisley Xhafa
Barka, 2011

Këpucë, ngjitës / Shoes, glue
430 x 140 x 60 cm

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana













Sislej Xhafa
***Rocket Ship*, 2011-2018**

Karrocë dore, drita të kuqe shkëlqyese / Wheelbarrow, red light strings
50 x 135 x 57 cm

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana









Sislej Xhafa
Concetto in Exile, 2018

PVC reklama nga mbuloja kamionësh në dërrasë / PVC advertising truck boards on stretcher
230 x 365 cm

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana









Sislej Xhafa
Piazza della Signoria, 1998

83

Lambda print
100 x 70 cm
Koleksion privat / Private collection



Sislej Xhafa

Padiglione Clandestino, 1997

Performansë e paautorizuar gjatë Edicionit 47 të Bienales së Venedikut, Pavijoni Shqiptar Klandestin /
Unauthorized performance during the 47th Venice Biennale, clandestine Albanian Pavilion

Lambda print

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë

Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana







Sisley Xhafa
***Sunshade*, 2011**

Çadër, rroba / Umbrella, clothes

Dimensione të ndryshueshme / Dimensions variable

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë

Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana









Sislej Xhafa
***Dressed Tone*, 2007**

Shirit, mikrofoni, kuti kartoni / Tape, microphone, cardboard box

Kabëll 225 cm i gjatë / Cable 225 cm long,

Kuti 85 x 55 x 58 cm / box 85 x 55 x 58 cm

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins

Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana









Sislej Xhafa
thithe, 2018

Cigare / Cigar
6cm

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana





Sislej Xhafa
***Stock Exchange*, 2001**

Video VHS e transferuar në DVD / Video VHS transferred to DVD

30' përsëritje e vazhdueshme / 30' loop

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havana

Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana



Sislej Xhafa
T, 2018

Shenjë reklamuese / Advertising sign
110 x 440 cm






Sislej Xhafa
***Skinheads Swimming*, 2002**

Video
4'58''

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana





Sislej Xhafa
***Future of Old*, 2001**

C-print, kornizë e artë / C-print, gold frame
85 x 60 cm

Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana





Sislej Xhafa
***Again and Again*, 2000-2018**

Performansë në bashkëpunim me Ansamblin e Qytetit të Gjakovës / Performance in collaboration with The Ensemble of the City of Gjakova
Me konsideratën e GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Pekin / Les Moulins / Havanë
Courtesy of GALLERIA CONTINUA, San Gimignano / Beijing / Les Moulins / Habana







love you with

out knowing

Sinclair Xhulwani:

Një pasdite me vapë të madhe

Sislej Xhafa, intervistuar nga Jérôme Sans

Si do ta përshkruanit punën tuaj?

Unë nuk jam i vetëdijshëm. Të paparashikueshme.

Çfarë saktësisht nënkuptoni me këtë?

Racionaliteti përgjigjet me racionalitet. Në procesin tim të hulumtimit nuk kam mënyrë racionale të të menduarit. Kur realiteti bëhet shumë më i fuqishëm se arti, unë vërtet besoj në atë realitet. Arti është udhëtim. Është përvojë e bukur kur e ndani hulumtimin tuaj me njerëzit. Aspekti më sfidues është gjetja e mënyrës për ta shprehur artin ashtu që të jetë i ndërlidhur me masat të cilat mbase kanë më pak gjasa ta pranojnë veprën artistike.

Si keni ardhur në art?

Për mua arti është ekzistencial dhe përderisa vazhdon rezistenca.

Jeni artist shqiptar nga Kosova me qëndrim në New York, ndërsa veprat e juaja shpesh ngrenë pyetje për vendlindjen tuaj dhe statusin e saj legal. Si e ndërlidhni punën tuaj me historinë dhe kontekstin sociopolitik të Kosovës?

Gjeografia është natyrë dhe varet nga aranzhimi i karakteristikave fizike, ndonëse vendlindja ime është e shenjtë për mua. Unë transformohem në diçka të veçantë nëpërmjet vendeve ku jam dhe prej nga vij. Në vazhdimësi duke e regjeneruar qëndrimin hibrid ndaj udhëtimit tim vetmitar nëpër largësitë që e sfidojnë universalen social-politike. Gjithmonë ndjem sikur të isha një qen rrugë i braktisur. Eci pa pasur asgjë, përveç instinktit tim i cili e energjizon fuqinë time shtytëse në botën e egër për vazhdimin e luftës që e spikat rezistencën për ekzistencë. Kjo është pasqyra ime në kuptimin prej nga vij dhe ku jam sot.

Jeni udhëtar i palodhshëm. Si ndikon ekzistenca juaj nomade në punën tuaj?

E ndjej që jam njeri prej balte, prej toke, dhe kjo tokë, kjo baltë, e ka një fërkim të habitshëm që vazhdimisht më jep. Nuk udhëtoj për gjëra, por udhëtimet e mia janë të detyrueshme, prandaj udhëtimi im është shndërruar në platformë për sfidim të vetvetes.

Cilat aspekte dhe tema të universales social-politike ju interesojnë më së shumti?

Padrejtësia nuk ka ngjyrë.

Pse e keni zgjedhur New York-un për ta themeluar studion/shtëpinë tuaj?

Si ndikon në punën tuaj përvoja e të jetuarit në New York?

E kam zgjedhur New York-un për arsye se si qytet është unik dhe i shumëllojshëm. Ofron hapësirë për përjetimin e një sërë kualiteteve jetësore. Nuk më intereson qyteti si i tillë, por zbulimi i korridoreve të tij.

Fakti se tash jetoni në New York a e reflekton gjithashtu dëshirën për t'u bërë sërish anonim, të zhdukeni përbrenda megaqytetit?

Rrokaqiejt e New York-ut janë shumë të gjatë dhe të lartë, unë jam shumë i vogël. Të qenit i padukshëm më jep hapësirë dhe kohë. Në fakt, studioja ime është një dollap i madh rrobash, derën e të cilit e mbylli hermetikisht. Aty kurrë nuk e dërgoj askënd, njerëzit i takoj nëpër hotele të ndryshme në New York. Studioja ime është vend intim, të cilin nuk mund ta ndaj me asnjëri sepse në të s'ka asgjë.

Keni jetuar edhe në Londër dhe në Itali. Cila ka qenë përvoja juaj në ato vende?

Çdo shoqëri, çdo shtet, e ka mentalitetin e vet. Çdo fshat e ka kualitetin e vet dhe mentalitetin e veçantë. Përvoja ime bën që të rritem dhe t'i shtroj pyetje vetvetes. Kualiteti të cilin e kam zbuluar në këto vende është fuqia e gjuhës si përvojë e

cila mund të të ofrojë dhe të stimulojë një imagjinatë më të gjerë. Për shembull: apple në anglisht, molla në shqip, mela në italisht, 苹果 në kinezisht, حوافت në arabisht, manzana në spanjisht, pomme në frëngjisht... Një fjalë me një kuptim që mund t'iu japë kaq shumë përvoja. Kjo është fuqia.

Puna juaj kryesisht përshkruhet si “konceptuale” dhe “e parespektueshme”. Çfarë mendoni?

Papërgjegjësia politike dhe padrejtësia sociale, imigrimi i detyrueshëm, etj. Këto janë të parespektueshme. Jam i ëmbël, prandaj jam i pafajshëm. Por ne, si shoqëri, kemi gjëra për të bërë me autoritetet. Në vitin 2000, për veprën Kënaqini lulet tona (*Pleasure Our Flowers*), stacionin kryesor policor e kam transformuar në një vend luksoz. Dëshiroja ta bëja atë ambient më të ngrohtë, sepse policia i takon popullit, prandaj e vura në pikëpyetje pse ambienti ishte aq i ftohtë? E transformova në një më të ngrohtë. Njerëzit erdhën ta shohin veprën time, ndërkohë që policia po punonte. Njerëzit po shkonin në një ambient të ngrohtë, kishte shampanjë, uiski, sofa, rrush, molla, libra filozofie dhe të shkencave humanistike, etj. Nëpërmjet artit dëshiroj ta jap një sipërfaqe tjetër nga brenda për të sfiduar ndogjë që të gjithë ne e ndajmë. Përmes Kënaqini lulet tona e kam kuptuar fuqinë e Artit.

Por, cila është marrëdhënia juaj me artin konceptual? A mendoni se jeni konceptual?

Unë i përkas Renesancës së Shëmtisë. Jemi dëshmitarë të kohës së dhunës globale, indiferencës, imigrimit të detyrueshëm, padrejtësisë sociale-politike dhe racizmit. Nëse Renesanca zakonisht i referohet të Bukurës, dua të shtroj pikëpyetje për shëmtinë e botës të cilën vetëm artet mund ta përkthejnë.

Sipas jush, cili është roli i artistit në shoqërinë tonë?

Artistët janë shtylla e shoqërisë. Aksioni si i tillë nuk zhvillohet në një dëshirë imituese, por bëhet rezistencë e vazhdueshme për ekzistencë.

Dikur keni deklaruar: “Realiteti është më i fuqishëm se arti. Si artist, nuk dëshiroj ta reflektoj realitetin, por dua ta vë në pikëpyetje. Edukimi im social gjatë rritjes nuk përfshin aksione racionale lineare. I qasem botës dhe jetës me sjellje primale instinktive”. Si do ta përshkruanit procesin tuaj artistik?

Kubi i bardhë është shpikje e tregut, hapësira është shpikje e lirisë.

Pra, çfarë marrëdhëniesh keni me institucionet artistike dhe tregun e artit?

Shumica e njerëzve në fshatin e peshkimit Msaka në Mala-vi zgjohen herët në mëngjes për t’iu dëshiruar mirëseardhje peshkatarëve dhe përgatisin peshkun për treg, ose një djalosh i vogël në Agra, Indi, që kalon orë të tëra në deponi të madhe (dhe tmerrësisht kutërbuese) mbeturinash, duke kërkuar ndonjë skrap të cilin do të mund ta shiste në treg gjatë ditës.

Shpesh bëni aluzione për lirinë. Si do ta përshkruanit këtë nocion?

Nuk ka filozofi dhe as ideologji në liri. Është e thjeshtë, praktike. Liria jonë mbaron atëherë kur e marrim peng lirinë e të tjerëve. Prandaj, arti mund ta ofrojë atë hapësirë të jashtëzakonshme të parashtrimit të pyetjeve.

Në bazë të kësaj ideje për lirinë, cilat janë hapësirat tuaja të preferuara të intervenimit?

Hapësira nuk duhet ta diktojë Artin, por Arti duhet ta vrasë hapësirën dhe të shpikë qëndrim të ri.

Si do ta përshkruanit procesin tuaj artistik? Si punoni?

Vetmia, hulumtimi dhe udhëtimi im janë irracionale. Nuk mendoj shumë. Zgjahem shumë herët në mëngjes, në orën tre, ndonjëherë në dy, ndonjëherë në katër, dhe e shijoj qetësinë, heshtësinë.

Punoni në medime të ndryshme, nga skulptura dhe vizatimi në performancë e fotografi. Si e kuptoni koherencën e punës suaj dhe kalimin nga një medium në tjetrin?

Ndjeshmëria ime ndaj praktikës është e paparashikueshme, prandaj nuk diktohem prej mediumit. Përvoja e zgjedh rrugën e vet.

Si përfshihet kjo “sjellje primale instinktive” në punën tuaj?

Mjedisi social, politik, ekonomik dhe kulturor është faktor i rëndësishëm në mënyrën në të cilën ka evoluar sjellja e lindur. Është qëndresë.

Nga Padiglione Clandestino tek Piazza Della Signoria, ose Skinkheaeds Swimming, cila është marrëdhënia juaj me artin e performansës?

Hije e aksioneve. Dëshmojmë, prandaj hapësira dhe koha janë unike.

Arti juaj i hulumton funksionet e shoqërisë bashkëkohore, realitetet sociale, ekonomike dhe politike, me qëllim që në fund ta kritikojë konsumerizmin dhe mekanizmat e tij. I sfidon stereotipat kulturorë, strategjitë e paramenduara të paragjytimeve dhe strukturat institucionale. A mendoni se puna juaj është politike?

“Për çka nuk mund të flitet, duhet heshtur”. Ludwig Wittgenstein.

Unë nuk jam politikan. Nuk kam tendenca. Prandaj, vazhdimisht i parashtoj pyetje vetes.

Me fjalët tuaja, a mund t’i jepni disa detaje për aspektet politike të veprave tuaja?

Jam i ëmbël, poetik dhe i ndruajtur. Nëse ka ndonjë aspekt politik ose ekonomik në artin tim, nuk jam i vetëdijshëm për këtë. Prandaj, definicioni i politikës vërtet është i diskutueshëm. Unë bëj art dhe i vë në pikëpyetje dimensionet e ndryshme - jo vetëm politikën, por ekonominë, turizmin. Të gjitha gjërat ndaj të cilave jemi të ndjeshëm gjithashtu mund të bëhen politike. Duke e shfrytëzuar të menduarit traumatik intelektual, qëllimi im ta sjell atë në një lloj qetësie dhe poezie të pakufishme, t’u jap njerëzve një përvojë.

Si ndiheni për ndërveprimin mes artit dhe politikës?

Fëmijët rioshë që tymosin cigare mund të bëhen politikë, ose zonja e bukur me xhakëtë luksoze me gëzof që shkon në kishë për t'u lutur mund të bëhet politike, njeriu që gërhet në gjumë mund të bëhet politik.

Që nga veprat tuaja të para e eksploronin nocionin e kufijve. Në vitin 1997, duke e vënë në pikëpyetje stereotipin tuaj - atë të emigrantit, keni hyrë ilegalisht në Bienalen e Venecias dhe e keni proklamuar veten si pjesëtar të *Pavijonit Klandestin të Shqipërisë*. A mund ta shpjegoni këtë gjest artistik më detajshëm?

Më shumë jam i interesuar në sfidimin e pozicionit të artit dhe sjelljen e freskisë së irracionalitetit për përjetimin e një dimension të ri përmes vet artit.

Zbulimi i Tjetrit është temë qendrore e veprës suaj. A mund të flisni për të?

Të gjithë ne jemi Tjetri.

Në ç'mënyrë i sfidoni stereotipat kulturorë?

Vazhdimisht duhet t'i sfidojmë vetët tona me të kuptuarit kulturor dhe për mënyrën në të cilën e perceptojmë çfarë është e ndryshme ose e huaj. Paragjykimet burojnë prej frikës nga tjetri.

Udhëtimi dhe proceset e turizmit janë tema qendrore universale të punës suaj. Çfarë do të thotë për ju fjala “udhëtim”?

Komfortet e materiales e prodhojnë hijen. Preferoj hijen.

Çfarë nënkuptoni me të preferuarit e hijes në raport me “udhëtimin”? Çkafit i referohet kjo në praktikën tuaj?

Përvoja dhe kërshtëria janë më të rëndësishme sesa destinacioni. Shpagimet e udhëtimit mund të vijnë prej përvojave dhe vetënjohjes së zhvilluar gjatë rrugës. Hija reflekton burrin, gruan, dhe fëmijët që ecin në dy këmbë.

Puna juaj gjithashtu është e ndikuar nga teoritë socio-ekonomike, ose statuset legale në Kosovë. Kontakti me dimensionin socio-ekonomik duket se gjithmonë arritet nën një vështrim të shumëfishtë. Si do ta shpjegoniit bashkëveprimin mes veprave tuaja dhe këtyre çështjeve? Politika është Arti i të folurit, Arti është politika e përvojës.

Cilat janë strategjitë tuaja për ta vënë në pikëpyetje dekonstruktimin e mitologjive dhe për ta sjellë vetëdijen në shoqëri?

Konstruksioni dhe dekonstruksioni i mitologjisë është puls universal dhe kolektiv. Si artistë, ne jemi më të ndjeshëm dhe më të përfshirë me pulsin.

A mendoni se njerëzit e kuptojnë dialogun dhe idetë të cilat synoni t'i inicioni me ta duke i vënë në pikëpyetje temat e tilla? A jeni i interesuar për mënyrën e pranimit të punës tuaj?

Mitet nuk i pretendojnë profecitë e veta, ato vetëm marrin frymë dhe nxjerrin frymë. Si artist, unë marr frymë dhe nxjerr frymë.

Cila është pjesa e humorit në punën tuaj?

Kur çështjet komplekse mund të shkaktojnë pjesëmarrje të thjeshtë. Ironia është mjet i jashtëzakonshëm i freskimit me qëllim që të sugjerohet ajo hapësirë e pjesëmarrjes të cilën kurrë s'mund ta marr peng.

Si do ta përshkruani këtë dimension të ndryshëm? Cilat kualitete dhe fjalë mund ta definojnë atë? A dëshironi t'i hapni ato për një gjendje më kontemplative me anë të pyetjeve universale, drejt formave të reja të të hapurit?

Kurioziteti dhe hulumtimi im vazhdon shtytjet drejt qendërmeve të reja.

Shpesh përdorni materiale të dobëta ose objekte të importuara, por ato janë të pasura me domethënie, si në *Rocket Ship (Anija Kozmike)* (2011), ose *Sunshade (Çadra e Diellit)* (2011). Ato shfaqen si mënyrë për të

shënjestruar më mirë dimensionin e ngarkesës konceptuale. Pse i zgjidhni ato dhe si e përzgjidhni materialin dhe objektet?

Materialet më zgjedhin mua dhe unë u besoj.

Arti juaj përfshihet në debatin politik për emigracionin. Nga perspektiva juaj, kush definohet si emigrant sot dhe çfarë kuptimi ka për ju fjala “emigrant”?

Emigrimi ka qenë pjesë e ekzistencës njerëzore gjithmonë. Është një ndër fenomenet më të vjetra në botë. Sot jemi dëshmitarë të zhvendosjes së detyrueshme të njerëzve, duke i spostuar rajonet e tëra. Emigrimi nuk mund të definohet me fjalë, por përmes vuajtjes së qenieve njerëzore. Ne përjetojmë një kohë të zhvendosjes së vazhdueshme, mentale dhe gjeografike. Jo gjithmonë jemi të vetëdijshëm për këtë. Mirëpo, në njërën prej formave të saja më ekstreme, kjo zhvendosje e vazhdueshme është e detyruar. Kjo është e papranueshme. Si artistë, ne duhet ta ofrojmë vizionin tonë dhe ta sfidojmë këtë fenomen të migrimit të detyruar, ndërsa të gjithë individualisht duhet t’i marrim përgjegjësitë që na takojnë.

Si e konsideroni këtë shpresë permanente për një jetë më të mirë diku tjetër, në raport me problematikën e migrimit që aktualisht është situatë globale?

Shpresoj që shpresa nuk është propagandë pasi realiteti është më i fuqishëm.

Cili është raporti juaj me realitetin?

Çdo mëngjes i rezistoj kafesë sime.

Në vitin 2017 e keni përfaqësuar Republikën e Kosovës në Bienalen e Venecias. Si keni ardhur tek ideja për projektin *Lost and Found (E humbur dhe e Gjetur)*? Çfarë është për ju e Humbur dhe çfarë e Gjetur?

Sot ne i vuajmë pasojat e luftës në Kosovë, të fatkeqësisë dhe shkatërrimit të njerëzve në vitin 1999. Njëra ndër plagët më shkatërruese është ajo e pashëruara e njerëzve të zhdukur

të Kosovës. Në fund të luftës në Kosovës, 5000 njerëz ishin të zhdukur. Me kalimin e viteve numri është zvogëluar, mirëpo 1664 njerëz ende janë të zhdukur. *E Humbur dhe e Gjetur (Lost and Found)* është projekti kryesor i cili e përkthen këtë tragjedi në tërë kompleksitetin e vet, duke e potencuar këtë periudhë të tranzicionit gjatë dhe pas luftës kur ishte vështirë të vlerësoheshin humbjet në njerëz. Kam konsideruar se njerëzit e Kosovës duhet ta shohin këtë vepër. Sepse nuk duhet ta fshehim të vërtetën. E vërteta gjithmonë del në sipërfaqe. Në anën tjetër, kam dashur që kjo vepër të bëhej një me natyrën, duke e krijuar kohën e vet. Zgjodha ta vendosja *E Humbur dhe e Gjetur në Pejë*. Vepra është e qasshme pas një shëtitjeje të bukur, në mes të asgjëkundit, në male. Marrëdhënia me mjedisin dhe natyrën e krijon një udhëtim të përsosur. Për mua Peja nuk është gjendje emocionale, por emergjencë. Në Pejë njerëzit mund ta kuptojnë një fragment të udhëtimit tim personal.

Pra, qëllimi juaj në këto vepra artistike është ta theksoni dinjitetin njerëzor, drejtësinë dhe transparencën përmes procesit të padrejtësisë?

Rezisto që t'ekzistosh.

Në vitin 2018, puna juaj do të ekspozohet për herë të parë në Kosovë, si pjesë e një retrospektive të madhe. Si e konsideroni idenë e kësaj ekspozite të parë në vendin tuaj të origjinës?

Sfiduese dhe shumë, shumë të ëmbël. Ekspozita është emocionale, mënyrë të cilën e kam parafytyruar për ta paraqitur atë raport me rininë time, bukurinë e natyrës dhe sesi puna ime mund ta diktojë hapësirën. Ekspozita është sfiduese dhe vendimi për ta ndarë këtë udhëtim ka krijuar një momentum magjik.

A është kjo arsyeja pse e keni zgjedhur titullin: *LOVE YOU WITHOUT KNOWING (TË DUA PA E DITUR)*? Do të jetë për (shpër)ndarjen?

Dashuria është utopi dhe njohja nënkupton zbulim. Nuk ekziston koha, as hapësira. Është diçka që nuk mund ta definoni.

Kjo ekspozitë do të jetë rikthim në Kosovë i disa veprave tuaja të cilat i keni krijuar në shtete të ndryshme. Si do ta planifikoni ta realizoni këtë proces të rigjallërimit të veprave tuaja?

Veprat e kanë jetën e tyre dhe mund të frymojnë kudo.

Cila është domethënia e veprës tuaj *Woven Soil* (2018)

Të fluturosh pa shkuar gjëkund. Titulli *Dheu i Endur* (*Woven Soil*) tashmë është vet vepra, pasi e sugjeron atë hapësirë. Fillimisht, ky projekt u mendua me Galleria Continua për Unlimited Basel, ku do të zgjaste gjashtë deri dhjetë ditë. E kisha menduar që nga fillimi i vitit 1999, pas shumë katastrofave njerëzore dhe bujqësore. Ndonëse jetojmë në vende urbane, qytete, prapë mbesim shoqëri bujqësore. Zvicra ka bërë përpjeke të mëdha për ta ndihmuar Kosovën pas luftës, veçanërisht në bujqësi. Ata i kanë transportuar 500 lopë për në Kosovë. Projekti im ishte që t'i falënderoja zviceranët duke i sjellë disa nga këto lopë sërish në Zvicër për t'i vizituar kushërinjtë e tyre. Kjo aventurë ishte plot me befasi: lopët do të duhej të kalonin përmes një itinerari të pabesueshëm, të qëndronin në karantinë me ditë jashtë habitatit të tyre natyror. Për shkak të pengesave në udhëtim, projekti dështoi. Projekti u rishfaq në Kosovë për ekspozitën *Të dua pa e ditur* (*Love You Without Knowing*). Kjo vepër ndërli dhej me botën bujqësore në institucionin e muzeut dhe e stimulonte marrjen në pyetje të vizitorëve të këtij simulakrumi të zhvendosjes.

A mund ta shpjegoni *Concetto in Exile* (*Fishekzjarrët në dollapin tim*) (2016)?

Hapësirë mes nostalgjisë dhe shpresës.

A mund të na thoni më shumë për *Landscape L* (*Peizazh L*) (2013), zemrën e madhe të vendosur në mur, të përbërë nga spiralet e metalta të dyshekëve? Kujt i referohet?

Komfortit.

Cilët janë artistët nga Kosova, Shqipëria, ose të nivelit ndërkombëtar, me të cilët ndiheni më të afërt?

Xhevdet Xhafa, babai im, mbetet inspirimi im i parë dhe më i

rëndësishmi. Ai e ka gdhendur themelin e udhëtimit tim, lirinë dhe qëndrimin pozicionues ndaj kohës dhe hapësirës. Kam gjetur inspirim të madh tek shkrimtarët si Ali Podrimja, Ludwig Wittgenstein dhe Shën Agustini (Rrëfimet).

Çfarë do t'i thoshit gjeneratës së re në Kosovë?

Bëhuni kureshtarë. Bëhuni të uritur. Bëhuni të përunjur.

Si do ta konsideroni fuqinë dhe ndikimin e krijimtarisë bashkëkohore në botën tonë të globalizuar?

Kreativiteti është energjia prapa vizionit që i ka ndërtuar të gjitha shoqëritë. Arti ka ndikim të fuqishëm në botën tonë, në mënyrë direkte dhe indirekte.

Si e shihni të ardhmen?

Duke vallëzuar.

Cila do të jetë ëndrra juaj e ardhshme?

Sjellja e të padukshmes në sipërfaqe.



LEPURI I ZI / BLACK RABBIT

Public talk with the artist Sislej Xhafa and curator Jérôme Sans /
Bisedë publike me artistin Sislej Xhafa dhe Kuratorin Jérôme Sans

A dog day afternoon

Sislej Xhafa interviewed by Jérôme Sans

How would you describe your work?

I am not conscious. Unpredictable.

What do you mean exactly by that?

Rationality responds with rationality. In my process of research, I do not have a rational way of thinking. When reality becomes much stronger than art, I truly believe in that reality. Art is a journey. It is a beautiful experience when you share your research with the people. The most challenging aspect is finding a way to express art in a way that is relatable to the masses that are perhaps less likely to embrace the art work.

How did you come to art?

Art for me is existential as the resistance continues.

You are a Kosovar Albanian artist based in New York, and your works often question your own birth country and the legal status of its. How do you link your work with the history and sociopolitical context of Kosovo?

Geography is the nature and relative of arrangement of physical features, although my birth place is sacred to me. I mutate through the places in which I am and where I come from into something special. Continuously, regenerating the hybrid attitude toward my solitude journey through distances that question the universal social political. I always feel as though I am an abandoned, stray dog. I walk with nothing but my instinct that energizes my driving force in the wild world to continue a fight that highlights the resistance to exist. That is my mirror in terms of where I come from and where I am today.

You are a tireless traveler. How your nomadic existence does affect your work?

I feel that I am the man of mud, earth, and this earth, this mud, has some incredible friction that gives to me continuously. I do not travel for commodities. My trips are forced

therefore; my traveling has become a platform of challenging myself.

Which aspects and themes of the universal social political interested you the most?

Injustice has no color.

Why did you choose New York to establish your studio?

How the experience of living in New York does influence your work?

I chose New York because it is unique and diverse as a city. It gives space to experience a range of life qualities. It does not interest me as a city itself rather my interest is in discovering the alleyways.

Does not the fact of moving to New York also reflect a desire to become anonymous again, to disappear within the megacity?

New York's skyscrapers are very tall and high, I am very little. Being invisible gives me space and time. My studio is actually a walk-in closet. And I close the door hermetically. I never take anyone there, I meet people in various hotels around New York. My studio is an intimate place that I can't share with no one because there is nothing there.

You also lived in London and Italy. What was your experience of these places?

Every society, every country, have their own mentality. Every village have their own quality and distinguished mentality. My experience makes me grow and question myself. The quality I have discovered in these countries is the power of language as experience that can give and stimulate you a broader imagination. Ex: apple in English, molla in Albanian, mela in Italian, 苹果 in Chinese, ةحافت in Arabic, manzana in Spanish, pomme in French...One word with one meaning that can give you so many experiences. This is the power.

Your work is mainly described as “conceptual” and “irreverent”. What do you think?

Political irresponsibility and social injustice, forced immigration etc. This is irreverent. I am sweet therefore, I am innocent. But we, as a society, have things to do with authorities. In 2000, for *Pleasure Our Flowers*, I transformed a main police station into a luxury place. I wanted to make that environment warmer, because police belong to the people, so I question why is the environment so cold? I transformed it into a warmer one. People came to see my work while police were working. People were going to a warm environment, there was champagne, whiskey, sofas, grapes, apples, books of philosophy and humanities etc. Through art I want to give a different surface from inside to question something that we all share. Through *Pleasure Our Flowers* I understood the power of Art.

But what is your relationship to conceptual art? Do you think you are conceptual?

I belong to the Renaissance of Ugliness. We are witnessing a time of global violence, indifference, forced immigration, socialpolitical injustice and racism. If the Renaissance usually refers to Beauty, I want to question the ugliness of the world that only arts can translate.

What is the role of the artist in our society according to you?

Artists are the backbone of the society. Action itself does not grow into a mimetic desire but become a continuous resistance to exist.

Once you stated: “Reality is stronger than art. As an artist, I do not want to reflect a reality but I do want to question it. My social upbringing does not embrace rational linear actions. I approach the world and life with primal instinctive behaviour”. How would you describe your artistic process?

White cube is an invention of the market, the space is an invention of freedom.

So, what is your relationship with artistic institutions and the art market?

Most of the people in the fishing village of Msaka in Malawi wake up early morning to welcome the fisherman and prepare the fish for the market or little boy in Agra, India spending hours on a big (and awfully stinking) rubbish dump looking for any scrap he could sell on the market later in the day.

You often allude to freedom. How would you describe this notion?

There is no philosophy, no ideology in freedom. It is just simple, practical. Our freedom ends when we hijack the freedom of others. Therefore, art can give that incredible space of questioning.

Which is your favorite space of intervention according to this idea of freedom?

The space should not dictate Art but Art should kill the space and invent new attitude.

How would you describe your artistic process? How do you work?

My solitude, research and journey are irrational. I don't think too much. I wake up very early in the morning, at three o'clock, sometimes two, sometimes four and enjoy the silence, the quietness.

You operate in various media, from sculpture and drawing to performance and photography. How do you apprehend the coherence of you work and the passage from own medium to another?

